

VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR. 11(448)

NENTOR 2025

ÇMIMI: 30 LEKË

Kryeredaktor: HALIL RAMA ; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI & BASHKIM HISARI ; website: www.VETERANIOBVL.ORG

SPECIALE

NËNTORËT E LIRISË SË SHQIPTARËVE



FAQE 4

HISTORIA

LANÇ, NJË NGA EPOPETË MË TË LAVDISHME TË POPULLIT SHQIPTAR



FAQE 5

95-VJETORI I DITËLINDJES

OBVLP, mesazh urimi për Prof. Hulusi Hakon GATI NJË SHEKULL KUJTESË DHE QËNDRESË...



Nga Pano Hallko

FAQE 7

“Haga jashtë kontrollit”, Grenell publikon pamjet nga protesta madhështore në Tiranë

LIRI ÇLIRIMTARËVE TË KOSOVËS

REAGIMI

Turistët rrugaçë fyejnë Faik Konicën dhe Frashëllinjtë

SEFER PASHA

Brezi që dhuroi jetën për lirinë e Shqipërisë na la një amanet: Atdheu është përgjegjësi

DËSHMORËT MBETEN TË RINJ NË SHEKUJ

Prof.asoc.dr. Bernard Zotaj

FAQE 13



• I dërguari i posaçëm i Presidentit amerikan Donald Trump, Richard Grenell, ka reaguar pas protestës së 17 tetorit në sheshin “Skënderbej” në Tiranë, ku mijëra qytetarë u mbledhën në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së. Grenell ka shpërndarë një video nga protesta dhe ka shkruar: “Haga është jashtë kontrollit. Kjo është ajo që ka bërë Jack Smith.”

FAQE 7

HISTORIA

BRIGADA QË U KRIJUA DITËN E PAVARËSISË

FAQE 6

DOSSIER

HISTORIA E TRISHTË E DR. YMER DISHNICËS

FAQE 10

DOSSIER

“FADIL HOXHA, SIÇ E NJOH UNË”, LIBRI I EKREM MURTEZAIT

FAQE 8

LIBRI

OMER NISHANI – JETA E NJË PRESIDENTI

HALIL RAMA

MJESHTËR I MADH

FAQE 9

DËSHMORËT MBETEN TË RINJ NË SHEKUJ

Prof.asoc.dr. Bernard ZOTAJ

FAQE 13

REFLEKSIONE

MOTIVIMI I TRADITAVE DHE VLERAVE KOMBËTARE NGA DASMAT KOSOVARE E SHQIPTARE

Nuri BUFI

FAQE 12

LIBRI I 30-TË

HALIL RAMA - Mjeshtër i Madh në publicistikë, por jo vetëm...



Kredoja e poetit del te poezia “Të rënëve”: “Në zemrat tona njëmijë herë jeni rritur, / Ju o pishtarë të lirisë / S’do harroheni në njëmijë breza, /Vepra juaj në piedestal është ngritur.” Në poezitë kushtuar vendlindjes në krye të vendit qëndron ajo për origjinën e Kastriotëve. Kujtojmë se autori e ka origjinën nga këto troje.

Nga Sakip Cami

FAQE 13

U PROMOVUA LIBRI “PO KTHEHEM NË HOTESH”



FAQE 14

SKËNDER MURRJA - mësuesi, që u dashurua me profesionin e tij të bukur

TATJANA PARLLAKU ÇARKAXHIU: “OBVLP krenohet me Skënderin, i cili punon me përkushtim për të mbajtur gjallë kujtimin, veprën dhe idealet e atyre që dhanë jetën për lirinë e atdheut. Ai dhe shumë pasardhës të tjerë të veteranëve, me shembullin e tyre, frymëzojnë brezat e rinj të rriten me dashurinë për vendin, për paqen dhe për njeriun”...

SPECIALE

Mijëra shqiptarë në protestë, mesazh Gjykatës Speciale nga Tirana: Drejtësi për ish-krerët e UÇK-së! Moisiu e Ali Ahmeti: Akuza të fabrikuara

LIRI ÇLIRIMTARËVE TË KOSOVËS

• Tirana, pasditen e 17 Tetorit 2025 u kthye në kryeqytetin e shqiptarisë, ku mijëra qytetarë për 1 orë bënë thirrje për drejtësi për ish-krerët e UÇK-së që prej 5 vitesh mbahen në qeli në Hagë. Protesta nisi me himnin kombëtar dhe sheshi "Skënderbej" u vesh me ngjyrat kuqezi. Nga Prishtina erdhi edhe djali i Hashim Thaçit.

TIRANË, 17 TETOR 2025 - "Unë jam UÇK". Kjo thirrje bëri bashkë mijëra shqiptarë në sheshin "Skënderbej" në Tiranë për të kërkuar drejtësi për ish-krerët e UÇK-së. Imazhi i ish-presidentit Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimit u shfaq krahas bustit të heroit kombëtar Gjergj Skënderbeu, ndërsa përballë tij mijëra shqiptarë jehuan me thirrjet "liri dhe drejtësi për çlirimtarët".

Protesta u zhvillua për 1 orë dhe nisi me himnin kombëtar shqiptar dhe bëri bashkë mijëra shqiptarë të cilët që prej orëve të para të mëngjesit vërshuan në kryeqytetin e shqiptarëve, Tiranën, për t'i dhënë mesazhin e qartë Gjykatës Speciale, se çlirimtarët e Kosovës po i mban padrejtësisht në qeli.

Këngët patriotike nuk munguan në protestë, ndërsa veteranët e UÇK-së udhëtuan nga Kosova të veshur me uniformën ushtarake, si dëshmi e gjallë e luftës për liri.

I pari që çeli protestën qe Organizatës së Veteranëve të Luftës të UÇK-së, Hysni Gucati

"Tirana sot është kryeqendra e Shqiptarëve. Sot nga kjo tokë i themi botës se nuk ishim kriminelë, por bijtë e këtij kombi që dhanë gjithçka për atdhe", tha ai.

Megjithëse me një shëndet të rënduar, ish-Presidenti Alfred Moisiu mbajti fjalimin e tij para mijëra shqiptarëve në



shesh, ku tha se liria nuk u dhurua, por u fitua me gjak. Akuzat e ngritura ndaj ish-krerëve të UÇK-së, bashkë me Ali Ahmetin i quajti të fabrikuara

"Është koha të mos heshtim, por të ngremë zërin sa më lart për të ngritur vendin tonë. Nuk mund të pranojmë të nëpërkëmbet gjaku i shqiptarëve. Liria e Kosovës nuk është dhuratë, është fituar me gjak, me sakrificë dhe vendosmëri. I bëj thirrje drejtësisë të tregojë veten për t'u bërë mësim të gjithëve", tha Ahmeti.

Ndërsa Mesazhi i Ali Ahmetit ishte i drejtpërdrejtë për qeverinë e Prishtinës,

që në këtë protestë mungoi. "Ka akoma në mesin tonë ca të pavetëdijshëm që i shërbejnë axhendave ruso-serbe në marrëdhëniet ndërshtetërore dhe mbjellin ndasi duke shpërndarë propagandën dashakeqe pa qenë fare të vetëdijshëm se po i shërbejnë Beogradit dhe Moskës. Liria e Kosovës nuk është arenë për politika individuale, partiake dhe zgjedhore. Liria e Kosovës nuk është pushkë për ndasi ndërshtetërore", tha ai. Djali i Hashim Thaçit, Endriti, e ndoqi nga afër, në krah të Taulant Ballës, kryebashkiakut të Prishtinës Përparim Rama dhe

Ogerta Manastirliut.

"Ju falenderoj të gjithëve për pjesëmarrjen, dua të falenderoj edhe zotin Rama që ka mbështetur këtë protestë dhe zotin Balla që është angazhuar dhe ka dhënë përkrahjen e tij maksimale", tha ai. Nga kjo protestë, një thirrje për t'i nderuar 4 liderët e UÇK-së iu bë edhe dy presidentëve të Shqipërisë dhe Kosovës.

"Dua t'ju bëj një propozim publik se, përveç thirrjeve, duhen edhe akte konkrete. I propozoj presidentit Begaj që djemtë që ndodhen në Hagë të nderohen me Urdhrin e Flamurit. I propozoj presidentes Vjosa Osmani t'i nderojë me titullin më të lartë që ia jep Kushtetuta, si dhe Këshillit Kombëtar të Malit të Zi dhe atij në Preshevë," deklaroi Haklaj.

Zemrat e pjesëmarrësve u ngritën herë pas here peshë nga këngët patriotike. Kryeministri Edi Rama nuk ishte pjesë e tubimit, por një dhuratë e UÇK-së e solli figurën e tij në mes të sheshit. Reagimin e tij e pati në distancë, ku ndau një video nga protesta me mesazhin e shkurtër "zemra mal".

Përfaqësuesit e lartë të opozitës munguan gjithashtu. I vetmi që u pa në thyrje të rregullit ishte Bujar Leskaj i Vlorës, si edhe Fatmir Mediu.

Pas tubimeve në Tiranë, Prishtinë e Hagë, mbështetja për 4 liderët e UÇK-së do t'i mbledhë shqiptarët edhe në Shkup.

Protestuesit në sheshin 'Skënderbej': Gjykata Speciale na ka vjedhur Presidentin dhe kreun e Kuvendit

Protestuesit në sheshin 'Skënderbej' kanë bërë thirrje për lirimin e ish-krerëve të UÇK-së, të cilët mbahen prej vitesh në Hagë.

Një protestues tha për mediat se Gjykata Speciale i ka vjedhur Kosovës dhe Presidentin dhe kreun e Kuvendit.

"Ata janë gjithçka për Kosovën, janë arkitektë për Kosovën. Ne pa ta nuk jemi as të formuar as si shtet. Kjo është diçka shumë e vogël që në mund të bëjmë që ata të jenë shumë shpejt në mesin tonë dhe të jenë aty ku u takon. Na e kanë vjedhur presidentin dhe kreun e Kuvendit. Nuk ka shtet pa ta. Ju e shihni sot, nuk kemi qeveri, nuk kemi as shtet", tha ai.

Ndërsa një tjetër protestues, tha se Kosova është shtet falë drejtuesve të UÇK-së. Ndërsa më tej hodhi akuza ndaj Gjykatës Speciale se po i mban drejtuesit e UÇK-së me dëshmi të falsifikuar.

"Falë tyre kemi shtet, falë tyre sot Kosova lëviz lirshëm. Falë tyre, fëmija im sot në shkollë. Çdo arritje që është bërë sot në Kosovë, është bërë falë tyre, duke filluar nga ushtria, policia etj. Një herë e përgjithmonë, drejtësia të shkojë në vendin e vet. Ne kemi pasur padrejtësi të tjera ndaj drejtuesve të UÇK-së. Të gjithë i kanë marrë në mënyrë të padrejtë në pyetje. Tani kjo Gjykatë Speciale me dëshmi të falsifikuar prej Serbisë", tha ai.

Gjithashtu një pjesëmarrës në protestë tha se nuk kishte ardhur për politikanët në protestë.

"Nuk kam ardhur për politikanët shqiptarë, se janë të gjithë të korruptu-



ar, por kam ardhur si gjak shqiptari", tha ai.

Një protestues tjetër bëri thirrje për lirimin e krerëve të UÇK-së.

"Flas në emrin tim dhe në emrin e këtyre, le të lirohen të pafajshmit", tha ai.

Ndërsa një tubues tjetër për pjesë marrje në protestë.

"Ju bëj thirrje të gjithë atyre që janë shqiptarë, të na bashkëngjiten në protestë"

MIJËRA SHQIPTARË KËRKOJNË DREJTËSI, JA PËR ÇFARË AKUZOHEN ISH-KRERËT E UÇK-SË DHE ÇFARË PO NDODH ME GJYQIN NË HAGË

Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, figura qendrore të ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ndodhen prej 5 vitesh të arrestuar në Gjykatën Speciale në Hagë, ndërsa procesi ndaj tyre nisi vetëm në vitin 2023. Thaçi ishte udhëheqës politik i UÇK-së para dhe gjatë luftës së viteve 1998-1999, Veseli drejtoi shërbimin e inteligjencës, Krasniqi ishte zëdhënës. ndërsa Selimi anëtar i shtabit të përgjithshëm.

Ndërsa gjithshka nisi nën pretendimet për trafik organesh, që nuk u vërtetuan kurrë, ndaj të katërve u ngritën akuza për burgosje të paligjshme, torturë, vrasje, krime kundër njerëzimit, zhdukje me forcë dhe persekutim të qindra civilëve dhe personave që nuk morën pjesë në luftime.

Krime të cilat dyshohet se ndodhën midis marsit 1998 dhe shtatorit 1999 në vende të ndryshme në Kosovë, por edhe në veri të Shqipërisë. Sipas Dhomave të Specializuara, Thaçi, Veseli, Krasniqi dhe Selimi mbajnë përgjegjësi penale personale për këto krime, por të gjithë ata janë deklaruar të pafajshëm. Avokatët mbrojtës kanë deklaruar se UÇK-ja nuk do të kishte fituar mbështetjen e bashkësisë ndërkombëtare nëse do të kishte ekzistuar një plan kriminal, siç pretendojnë prokurorët.

Sipas tyre, aktakuza bazohet në një keqinterpretim selektiv të ngjarjeve. Procesi në Hagë po shkon drejt përfundimit, pasi muajin e kaluar mbrojtja e Thaçit thirri dëshmitarët e parë.

SPECIALE

Reagon i dërguari i posaçëm i Presidentit amerikan Donald Trump, Richard Grenell

“Haga jashtë kontrollit”, Grenell publikon pamjet nga protesta madhështore në Tiranë

I dërguari i posaçëm i Presidentit amerikan Donald Trump, Richard Grenell, ka reaguar pas protestës së 17 tetorit në sheshin “Skënderbej” në Tiranë, ku mijëra qytetarë u mbledhën në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së.

Grenell ka shpërndarë një video nga protesta dhe ka shkruar: “Haga është jashtë kontrollit. Kjo është ajo që ka bërë Jack Smith.”

Në një tjetër reagim, ai shton:

“...edhe në Tiranë”, duke nënvizuar se kjo ishte një nga protestat më të mëdha të mbajtura kundër proceseve në Gjykatën Speciale, pas atyre në Prishtinë dhe Hagë. Ai ka komentuar kështu protestën në Tiranë kundër Gjykatës Speciale. Ky reagim tregon se protestat për drejtësi ndaj ish-udhëheqësve të UÇK-së po marrin vëmendje ndërkombëtare, veçanërisht nga figura të rëndësishme politike në SHBA.



Mediat ndërkombëtare jehonë protestës në Tiranë:

Mijëra njerëz u ngritën kundër gjykatës së mbështetur nga BE, ndjek penalisht ish-luftëtarët e UÇK-së

• **Thirrjet e mijëra shqiptarëve të mbledhur në sheshin ‘Skënderbej’ me 17 Tetor 2025 bënë jehonë në mediat ndërkombëtare. Mediat shkruajnë se qytetarët protestuan kundër Gjykatës Speciale të Hagës, që mbështetet nga BE, për gjyqin e padrejtë ndaj ish-krerëve të UÇK.**

Zëri i mijërave qytetarëve që u mbledhën pasditen e së premtes në Tiranë në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së në Kosovë bëri jehonë ndërkombëtare. Mediat e huaja si Associated Press, The Telegraph, Neë York Post apo Ëashington Post kanë shkruar për thirrjet që u bënë për drejtësi ndaj gjyqit të padrejtë që po iu bëhet Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit.

Associated Press shkruan se qytetarët u mbledhën në kryeqytetin e Shqipërisë për të protestuar kundër Gjykatës Speciale të Hagës të mbështetur nga BE, duke e cilësuar si të njëanshme, dhe që ndjek penalisht ish-luftëtarët e tyre që zhvilluan luftën

e viteve 1998-1999 për pavarësi nga Serbia.

“Demonstrues nga Kosova dhe vende të tjera evropiane mbushën sheshin kryesor Skënderbej në Tiranë në mbështetje të ish-udhëheqësve të arrestuar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ose UÇK-së — një ish-grup guerilas i shqiptarëve të Kosovës që udhëhoqi luftën për pavarësi. Shumë prej tyre mbanin flamuj kombëtarë shqiptarë dhe të UÇK-së, ndërsa një grup ish-luftëtarësh dhe disa të rinj ishin të veshur me uniforma të UÇK-së. Disa këndonin këngë për UÇK-në dhe lirinë.”, thuhet në artikull.

Mediat theksojnë gjithashtu se protesta nuk ishte politike dhe se “u organizua nga shoqata e veteranëve e njohur si OVL-UÇK dhe u mbështet nga qeveria dhe kryeministri i Shqipërisë, nën moton: “Liria ka një emër. Drejtësi për çlirimtarët.”

Vihet theksi edhe te prezenca e ish-presidentit Aleksandër Moisiu.

“Alfred Moisiu, 95 vjeç, ish-presidenti i Shqipërisë, ishte gjithashtu i pranishëm dhe bëri thirrje për drejtësi, duke

thënë se të pandehurit “janë ndaluar pa prova, me akuzat të sajuaara”.

Përmendin gjithashtu edhe numrin e shqiptarëve të vrarë gjatë luftës dhe tensionet që vijnë ende me Serbinë.

“Gjykata dhe një zyrë prokurorie e lidhur me të u krijuan pas një raporti të vitit 2011 nga Këshilli i Evropës, një organ i të drejtave të njeriut, që përfshinte akuzat se luftëtarët e UÇK-së trafikuan organe njerëzore të marra nga të burgosurit dhe vranë serbë dhe bashkëqytetarë shqiptarë etnikë. Akuzat për marrjen e organeve nuk janë përfshirë në aktakuzat e lëshuara nga gjykata.

Dy ish-anëtarë të tjerë të UÇK-së janë dënuar tashmë nga gjykata. Guçati dhe një zyrtar tjetër i UÇK-së u dënuan gjithashtu nga gjykata për kërcënim të dëshmitarëve dhe pengim të drejtësisë.

Rreth 11,400 njerëz, kryesisht shqiptarë etnikë, vdiqën gjatë luftës, përpara se një fushatë bombardimi e NATO-s ta detyronte Serbinë të tërhiqte trupat e saj nga Kosova dhe t’ia dorëzonte kontrollin e ish-provincës së saj Kombeve të Bashkuara dhe NATO-s.

Kosova shpalli pavarësinë e saj nga Serbia në vitin 2008, e cila u njoh nga Shtetet e Bashkuara dhe pjesa më e madhe e Perëndimit, por jo nga Serbia apo aleatët e saj Rusia dhe Kina. Tensionet midis Kosovës dhe Serbisë mbeten të larta”, thuhet në artikullin e Associated Press.

Dy protesta të tjera u organizuan këtë vit nga veteranët e UÇK-së, njëra në Prishtinë më 7 gusht dhe tjetra në Hagë më 14 shtator, një ditë para se të fillonte seanca dëgjimore e dëshmitarit të parë të mbrojtjes, ish-ndihmës sekretarit të shtetit të SHBA-së, James Rubin.

PËRGATITI FAQET: KIMETE RAMA

Foto nga protesta pro UÇK në Tiranë

ISH PRESIDENTI MOISIU: QARQET SERBO-RUSE FABRIKUAN AKUZAT PËR ISH KRERËT E UÇK-SË! NUK MUND TË NËPËRKËMBET GJAKU SHQIPTAR

Ish presidenti i Shqipërisë, Alfred Moisiu, ishte i pranishëm në protestën që u mbajt në sheshin “Skënderbej” në Tiranë më 17 Tetor 2025, në mbështetje të ish krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët po gjykohen në Hagë.

Në fjalën e mbajtur nga podiumi i tubimit, Moisiu tha Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi dhe Kadri Veseli kanë bërë detyrën më të lartë që një historia bashkëkohore: çlirimin e Kosovës dhe mbrojtjen e popullit të vet.

Për ish presidentin shqiptar, akuzat ndaj liderëve historikë të UÇK-së janë të fabrikuara nga qarqet serbo-ruse, por bëri thirrje që të mos lejohet nëpërkëmbja e gjakut të dëshmorëve shqiptarë të rënë për lirinë e Kosovës.

“Të dashur qytetarë të Tiranës, Shqipërisë dhe Kosovës, Maqedonisë së Veriut, Preshevës dhe Malit të Zi, të dashur bashkëkombës, sot jemi mbledhur këtu në zemër të Tiranës. Jemi mbledhur për të mbrojtur dinjitetin kombëtar, për të ngritur zërin kundër padrejtësisë që po u bëhet bijve më të mirë të Kosovës dhe të kombit shqiptar, luftëtarëve të UÇK-së, që luftuan për lirinë e atdheut.

Në vitin 2022, bashkë me presidentin Rexhep Meidani, Bamir Topi, Pandeli Majko, në dhomat e paraburgimit për të takuar personalisht presidentin Thaçi, me Jakup Krasniqin, Kadri Veselin dhe Rexhep Selimin, në bisedë me këta burra kuptova dhe pashë se ata trima nuk ishin të frikësuar, por burra të vërtetë, qëndronin të qetë, të gatshëm për t’u sakrifikuar për të pasur luftën e UÇK-së pa njollat që padrejtësisht duan t’i japin ata që nuk i njohin mirë shqiptarët.

Ata kanë bërë detyrën më të lartë që një historia bashkëkohore: çlirimin e Kosovës dhe mbrojtjen e popullit të vet. Unë besoj se drejtësia do të bëjë detyrën e saj dhe do të jetë në krahun e katër vëllezërve të UÇK-së. Janë burgosur pa prova, me akuzat të fabrikuara në qelat e errëta serbo-ruse. Dua të theksoj se lufta e UÇK-së u mbështet fuqishëm nga NATO dhe SHBA, dhe nga partnerët e rëndësishëm perëndimorë.

Komandantët udhëheqës të UÇK-së, dëshiroj të them se shqiptarët historikisht njihen si luftëtarë, por në tre raste janë shqiptarët që kanë luftuar për veten: në kohën e Skënderbeut, gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe UÇK. Të dashur miq, është koha të mos heshtim, por të ngremë zërin sa më lart për të ngritur vendin tonë. Nuk mund të pranojmë të nëpërkëmbet gjaku i shqiptarëve. Liria e Kosovës nuk është dhuratë, është fituar me gjak, me sakrificë dhe vendosmëri. I bëj thirrje drejtësisë të tregojë veten për t’u bërë mësim të gjithëve. Lavdi dëshmorëve të UÇK-së, liri luftëtarëve të UÇK-së”,- tha Moisiu.

SPECIALE



28 nëntori është një datë, e cila e ka shoqëruar Shqipërinë në çdo etapë të historisë së saj

NËNTORËT E LIRISË SË SHQIPTARËVE

Muaji nëntor në Kalendarin e historisë kombëtare shqiptare shënon ngjarjet më të mëdha dhe më të rëndësishme të kombit shqiptar. Ky muaj shënon kthimin e Skënderbeut në Krujë, në vitin 1443, Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë në vitin 1912, Çlirimin e Shqipërisë nga forcat fashiste në vitin 1944, lindjen e Komandantit Legjendar të UÇK-së, Adem Jashari në vitin 1955, daljen publike të UÇK-së në vitin 1997 dhe shumë ngjarje të tjera të rëndësishme të së kaluarës shqiptare...

GJITHÇKA, FILLOI MË 28 NËNTOR 1443.

Ishte viti shumë i largët 1443, kur në këtë ditë të shënuar, heroi kombëtar i Shqipërisë, Gjergj Kastrioti, ngriti flamurin e shqiponjës dykrenare mbi kalanë e Krujës, duke e çliruar atë nga pushtimi osman.

Gjergj Kastrioti me në sfond flamurin me shqiponjë dykrenare

Plot çerek shekulli, me një ushtri të përbërë nga 10 mijë ushtarë, ai qëndroi i palëkundur ndaj forcave osmane. Kështu, duke u bërë një qëndrestar i vërtetë, i cili e mbajti larg Evropës pushtuesin Osman, deri në çastin kur vdiq, më 17 janar 1468.

Do të duhet të kalonin 469 vite, për ta riparë Shqipërinë sërish larg zgjedhës osmane – të lirë.

NËNTORI I DYTË

Nëntori më i rëndësishëm për shqiptarët mbetet pa diskutim ai i vitit 1912 – edhe pse i dytë.

Nën gjurmët e historisë, duke ndjekur Skënderbeun, Ismail Qemali, nisi rrugëtimin e tij drejt qytetit bregdetar të Vlorës, ku dhe nga ballkoni i shtëpisë së tij, ngriti flamurin – sërish me shqiponjën dykrenare, të qëndisur nga Marigoja – dhe e shpalli Shqipërinë të pavarur nga perandoria osmane.

Ngritja e flamurit në Vlorë, 1912

Kuvendi Kombëtar i Vlorës, ishte organi i cili e shpalli mëvehtësinë. Ky akt shpalljeje, përbën një ndër ngjarjet më të rëndësishme në historinë e popullit shqiptar. Kjo ditë, përkujtohet si fryti i përpjekjeve dhe i luftërave shekullore të shqiptarëve, për të mbrojtur tërësinë tokësore të atdheut dhe për të formuar shtetin e pavarur shqiptar.

Dalja nga zgjedhja pesëshekullore e osmanëve, ishte një aspekt. Por aspekti tjetër – edhe më i rëndësishëm – ishte ai i krijimit të një Shqipërie me zhvillim ekonomik. Kjo, si thirrje për daljen nga prapambetja e pushtimit.

Me pushkë dhe me penë, Shqipëria ishte e pavarur dhe historia moderne e saj, do të merrte jetë.

28 NËNTORI I MIRATIMIT TË KUSHTETUTËS SË SHQIPËRISË PLURALIST

Sakaq, një tjetër 28 nëntor me shumë rëndësi, këtë herë për kushtetutshmërinë e vendit, ishte ai i vitit 1998, kur me dekret të presidentit të asaj kohe, Rexhep Meidani, ajo u dekretua dhe hyri në fuqi, duke vërtetuar dhe hyri në fuqi, duke vërtetuar

dosur kështu gurthemelin e shtetit ligjor shqiptar të pas-diktaturës.

28 NËNTORI I JASHARIT

Data, jo më kot quhet e veçantë për shqiptarinë, pasi ajo nuk njeh kufij. Përtej festës kombëtare të pavarësisë, ka edhe një sërë ngjarjesh të tjera, të cilat përkujtohen në ditën e shenjtë të flamurit.

Në këtë datë të vitit 1955, në Prekaz të Skënderajt, do të lindte edhe komandanti legjendar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jashari.

Në vitin 1991, Jashari mori pjesë në disa sulme kundër xhandarmërisë serbe. Më pas, ai erdhi në Shqipëri për të marrë trajnim ushtarak. Do të ishte viti 1993, kur Jashari do të rikthehej në Kosovë, nga ku edhe vijoi sulmet kundër establishmentit jugosllav.

Në korrik 1997, një gjykatë jugosllave do ta dënonte Jasharin për veprën e "terrorizmit në mungesë".

Por, ai nuk do të mund të kapej asnjëherë nga regjimi serb.

Komandanti legjendar i UÇK-së, Adem Jashari

Do të ishte viti 1998, ai kur Policia serbe, ndërmori një sulm kundrejt banesës së Jasharit. Një betejë e vërtetë u zhvillua, ku 57 familjarë të Jasharëve, përfshi Ademin, gruan, djalin dhe vëllain e tij, mbetën të vrarë.

Shtatë vjetët si komandant i UÇK-së, e kanë rrënjësuar figurën e tij si një ndër më të nderuarat nga populli i Kosovës. Për lirinë e kombit, ai dha jetën.

28 NËNTORI I SHQIPTARËVE TË KOSOVËS

Vetë populli i Kosovës, e përkujton datën jo vetëm për ngritjen e flamurit në Shqipëri.

Më 1969-ën, për herë të parë në Kosovë, u lejua përdorimi i simbolit kombëtar. Pra, ai i flamurit kuqez.

Ngritja e flamurit – për të tretën herë – do të vinte edhe jashtë kufirit faktit shqiptar, por brenda kufirit natyral.

Më 28 nëntor 1997, UÇK-ja do të paraqitej për herë të parë në skenë si entitet, për lirinë e Kosovës.

UÇK-ja del për herë të parë publikisht, 28 nëntor 1997

Me miratimin pikërisht të Adem Jasharit, në rastin e varrimit të mësuesit dëshmor, Halit Geci, në fshatin Llaushë, tre luftëtarë të lirisë, Mujë Krasniqi, Rexhep Selimi dhe Daut Haradinaj, dolën publikisht të maskuar, por me uniformë të UÇK-së.

Ndërsa, një arsye tjetër, simbolike këtë herë, për të kremtuar 28 nëntorin, është ajo e ngritjes së përmendores së Skënderbeut, në vitin 2001, në Prishtinë.

Për një arsye, ose për disa, 28 nëntori është një datë, e cila e ka shoqëruar Shqipërinë në çdo etapë të historisë së saj.

Mbi këtë ditë, kultura dhe tradita e një kombi, shëmbëllojnë domethënien e tyre.

Domethënien e historisë së vjetër së një shqiponje me dy kokë, por me një trup të vetëm, atë shqiptar.

HISTORIA

Mesazhet e mëdha të lirisë, paqes dhe luftës kundër tiranisë, tingëllojnë edhe sot më aktuale se kurrë

LANÇ një nga epopetë më të lavdishme të popullit shqiptar

- *Shqipëria është vendi i parë në Ballkan që u çliruan me forcat e veta, ndërsa të gjitha shtetet e tjera të Ballkanit u çliruan me ndihmën e Armatës së Kuqe*



- *Ushtria Nacionalçlirimtare (NÇI) lindi dhe u plotësua nga populli me njësite guerile, çeta partizane, batalione, grupe operative, brigada, divizione dhe korparmata, të shpërndara në të gjithë territorin duke arritur deri në 70 000 forca partizane...*

Më 29 nëntor të vitit 1944 Shqipëria, pa ndihmën e askujt por me forcat e veta luftarake u çlirua nga pushtimi fashist. Prej 7 prillit të vitit 1939 e deri më 29 nëntor të vitit 1944, Shqipëria kishte qenë e pushtuar nga Italia fashiste dhe pas kapitullimit të saj, në vjeshtë të vitit 1943, Shqipëria pushtohet nga forcat gjermane. Në fund të nëntorit 1944, pas Çlirimit të Tiranës, më 17 nëntor dhe pjesës kryesore të Shqipërisë së Veriut, mbetej te çlirohej qyteti i Shkodrës dhe qarku i tij. Pa Shkodrën e çliruar nuk mund të kishte Shqipëri të çliruar. Shkodra nuk ishte vetëm një territor, ajo kishte qenë dhe ishte shpirti i Shqipërisë, kryqendra historike e Veriut te saj, kryeqyteti i lashtësisë së saj ilire Shkodra ishte qendra e fundit në Shqipëri ku qenë grumbulluar rreth 3000-4000 gjermanë dhe 2500 bashkëpunëtorë të tyre. Informacionet e kohës japin të dhëna për bashkëpunëtorë të tjerë. Shkodra u çlirua më 29 nëntor të vitit 1944, datë kjo e cila shënon ditën e çlirimit të Shqipërisë nga pushtimi gjerman. Shqipëria është vendi i parë në Ballkan që u çliruan me forcat e veta, ndërsa të gjitha shtetet e tjera të Ballkanit u çliruan me ndihmën e Armatës së Kuqe.

pushtimit të Shqipërisë.

Prej 7 prillit të vitit 1939 e deri më 29 nëntor të vitit 1944, Shqipëria kishte qenë e pushtuar nga Italia fashiste dhe pas kapitullimit të saj, në vjeshtë të vitit 1943, Shqipëria pushtohet nga forcat gjermane.

Në fund të nëntorit 1944, pas Çlirimit të Tiranës, më 17 nëntor dhe pjesës kryesore të Shqipërisë së Veriut, mbetej te çlirohej qyteti i Shkodrës dhe qarku i tij. Shkodra u çlirua më 29 nëntor të vitit 1944.

Ky moment historik konsiderohet si operacioni më i rëndësishëm, më i ashpri dhe më i suksesshmi, që kanë zhvilluar njësitë e UNÇSH kundër forcave gjermane e bashkëpunëtorëve të tyre për çlirimin e qyteteve të Shqipërisë. Rol të veçantë për suksesin e operacionit luajti beteja e Mushqetasë. Lufta për çlirimin e Tiranës kishte karakterin e luftës së vërtetë balllore, ku u dukën qartë shkalla e organizimit të UNÇSH.

Në luftën për çlirimin e Tiranës, një kontribut të çmueshëm dha populli i kryeqytetit, i cili i mbështeti fuqimisht të gjitha luftimet që u zhvilluan nëpër lagjet dhe rrugët e tij.

81 vjet më parë, djemtë dhe vajzat partizane, bashkë me qytetarët kryengritës të Tiranës, do të realizonin një nga operacionet ushtarake më të lavdishme dhe më të suksesshme, duke i dhënë të drejtën dhe kredon brigadave partizane për të hyrë fitim-

tare në kryeqytet. Për të ardhur te kjo ditë e bardhë, u desh gjaku dhe jeta në lulen e rinisë e qindra Dëshmorëve, sakrificat dhe përpjekjet e mijëra partizanëve në çdo shesh, rrugicë, barrikadë dhe shtëpi të kryeqytetit.

Çlirimi i Tiranës ishte një kontribut i rëndësishëm për të forcuar legjitimitetin dhe besueshmërinë e Shqipërisë, si një vend i përkushtuar në Aleancën Antifashiste. Mesazhet e mëdha të lirisë, paqes dhe luftës kundër tiranisë, tingëllojnë edhe sot më aktuale se kurrë, të nderuara dhe të pacënuara nga koha dhe devijimet e mëvonshme të kauzës së lirisë të partizanëve tanë të lavdishëm.

* * *

Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare është një nga epopetë e luftërave më të lavdishme që ka bërë populli ynë. Kjo luftë filloi me rezistencën ndaj pushtuesve fashistë më 7 prill 1939 dhe vijoi kundër pushtuesit gjerman deri në çlirimin e plotë më 29 nëntor 1944. LANÇ ishte epopeja më e lavdishme dhe që i tregoi botes se si edhe një popull i vogël lufton dhe fiton kundra dy armiqtë të mëdhenj. Në vitet 1939-1944, lufta që bëri populli ynë dhe ushtria jonë NÇI na bashkoi me koalicionin e Madh Antifashist: Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Sovjetik dhe Anglia. Ushtria Nacionalçlirimtare (NÇI) lindi dhe u plotësua nga populli me njësite guerile, çeta

partizane, batalione, grupe operative, brigada, divizione dhe korparmata, të shpërndara në të gjithë territorin duke arritur deri në 70 000 forca partizane. Nga dita në ditë rritej besimi tek populli, tek UNÇI duke parë konkretisht se e vetmja shpresë ishte lufta ANÇL, prandaj rriteshin dhe forcat partizane, duke u organizuar dhe përgatitur për një sulm të përgjithshëm në të gjithë vendin. Në tetor 1944 u formuan shumë reparte partizane duke përfshirë edhe divizione. Në të njëjtën kohë ishte çliruar 70-80% e territorit duke përjashtuar qytetet që shtriheshin gjatë rrugëve nacionale që i zotëronin trupat gjermane për lëvizjen e trupave nga Jugosllavia, Greqia e Kosova, por që në fund kulmoi me çlirimin e gjithë Shqipërisë. Kështu që nisur nga historia, e theksoj se Lufta Partizane ishte e kristaltë, ka qenë luftë idealesh të pastra dhe është krenari për të gjithë Shqipërinë. Duhet theksuar se në Luftën e Dytë Botërore, ne shqiptarët, ashtu si edhe popujt e tjerë të Europës dhe më gjerë, me luftën heroike partizane u angazhuam në një përpjekje të madhe, luftarake dhe të përgjakshme, si aleatë në krah të koalicionit të madh antifashist. Nuk duhet harruar se Shqipëria jonë e vogël pagoi një çmim të jashtëzakonshëm gjaku dhe sakrificash të panumërta njerëzore. Nderimi i këtyre sakrificave është nderi i çdo gjenerate shqiptarësh. Prandaj nderimi i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, nderimi i dëshmorëve dhe heronjve të lavdishëm të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, nderimi i çdo faqeje të kësaj lufte dhe i vetë datës së çlirimit të vendit tonë, në 29 nëntor 1944, është nderi i çdo shqiptari. Ka patur gjithmonë përpjekje në këto 35 vite për të hedhur baltë ndaj Luftës Antifashiste, ndaj dëshmorëve. Sakrificat e mijëra djemve dhe vajzave të Shqipërisë që ranë me një idealizëm të pasqorë në luftën për çlirim as nuk mund të mohohet, e padyshim meriton më tepër. Meriton shumë më tepër sesa fjalët, edhe sesa përveç fjalëve është mundur të bëhet e tregohet gjithë këto vite. Nuk duhet dhe nuk mund të ngatërrohet epopeja e Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare me atë që pasojë pas 1945. Prandaj, çdo nderim që i bëhet çdo dëshmorë që dha jetën për Çlirimin e Atdheut, çdo nderim që bëhet në familjet e dëshmorëve është një vlerë që shoqëria jonë duhet ta përçojë.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, Ushtria Nacionalçlirimtare e Shqipërisë zhvilloi kryengritje të armatosur kundër

HISTORIA

U krijua në Ditën e Flamurit për të mbajtur të papërlyer Flamurin e Skënderbeut e Ismail Qemalit

• **Komandanti i Përgjithshëm Spiro Moisiu i dorëzoi flamurin luftarak komandantit të Brigadës Beqir Balluku. Kjo ditë u kthye në një ditë feste ku nuk pushuan këngët partizane e patriotike dhe vallet popullore. Brigada II Sulmuese, jo rastësisht u formua në Shqipërinë e Mesme, në afërsi të kryeqytetit, në zemrën e reaksionit më të tërbuar**

BRIGADA QË U KRIJUA DITËN E PAVARËSISË



Historia e Brigadës II Sulmuese është historia e luftës dhe e përpjekjeve të atyre bijve dhe bijave shqiptarë që erdhën në gjirin e kësaj njësie nga zona dhe krahina të ndryshme të Tiranës, Elbasanit, Gjirokastrës, Mallakastrës, Kurveleshit, Kolonjës, Librazhdit etj. Këta bij e bija të thjeshtë të popullit vullnetarisht lanë vatrat e ngrohta qetësinë e tyre familjare dhe u bashkuan me familjen e madhe partizane ku luftuan me trimëri e vetmohim në emër të çështjes të çlirimit kombëtar dhe shoqëror të popullit, për të mbajtur të papërlyer Flamurin e Skënderbeut e Ismail Qemalit, për një jetë më të mirë pa shtypje dhe shfrytëzim, për të cilën dhanë kontributin e tyre të çmuar.

Brigada II Sulmuese është një nga formacionet e para e më të mëdha partizane. Ajo u krijua me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇ SH, më 28 Nëntor 1943, në fshatin Skrep të Shëngjergjit në rrethin e Tiranës. U krijua pikërisht në ditën simbol të kombin tonë, në ditën e shpalljes së pavarësisë që të luftonte për të shporrur pushtuesit fashistë e pr të fituar lirinë e munguar e pavarësinë e humbur. Në inaugurimin e Brigadës mori pjesë vetë udhëheqësi i Luftës, Enver Hoxha, i cili përshëndeti partizanët dhe popullin e Shëngjergjit e fshatrave të tjerë përreth me një fjalim shumë të rëndësishëm i cili ngriti peshe zemrat e partizanëve, masës së popullatës, sidomos të rinisë të kësaj zone. Komandanti i Përgjithshëm Spiro Moisiu i dorëzoi flamurin luftarak komandantit të Brigadës Beqir Balluku. Kjo ditë u kthye në një ditë feste ku nuk pushuan këngët partizane e patriotike dhe vallet popullore.

Brigada II Sulmuese, jo rastësisht u formua në Shqipërinë e Mesme, në afërsi të kryeqytetit, në zemrën e reaksionit më të tërbuar. Koha, vendi dhe situata në të cilën lindi Brigada II Sulmuese karakterizohet nga një sërë vështirësi serioze. Ishte Dimër dhe zona ku vepronin partizanët ishte ndër më të varfërat. Ishte pragu i Operacionit të madh të Dimrit, të cilin pushtuesit nazistë dhe tradhtarët e Ballit Kombëtar e të Legalitetit e kishin përgatitur prej kohësh duke patuar si qëllim që, me anën e tij, të zhduknin Shtabin e Përgjithshëm, të shkatëronin Ushtrinë NÇSH dhe të shuanin krejt luftën partizane e cila ishte bërë tmerr për armiqtë dhe shpresë për popullin.

Pavarësisht vështirësive, që nga

dita e krijimit e deri në çlirimin e plotë të Shqipërisë Brigada II kreu aksione të njëpasnjëshme kundër pushtuesve nazistë. Ajo përshkoi territore e zona të tëra në gjithë Shqipërinë dhe çliroi një sërë krahinash e qytetesh. Ajo përshkoi një rrugë plot sakrificë, e heroizëm. Ajo mbajti gjithnjë lidhje të ngushta me popullin, luftoi me heroizëm dhe u bëri ballë operacioneve naziste – gjermane dhe reaksionit më të madh e të egër të Shqipërisë së Mesme në dimrin e vitit 1943-1944. Në aktivitetin e saj luftarak Brigada II Sulmuese ka një varg veprimesh të rëndësishme luftarake e politike.

Ajo zhvilloj luftime kundër pushtuesve në krahinën e Dibrës, Çermenikë, në krahinën e Tiranës; Priskë, Brar, Pezë, Fushë-Krujë, Ishëm, në rrethinat dhe brenda në Tiranë. Një nga aksionet brenda në kryeqytet ajo kreu aksionin kundër forcave mercenare në "Shkollën e Kuqe", më 17 janar 1944 ku njësi partizane e komanduar me zgjuarsin, zotësi e trimëri të rrallë nga komisar i batalionit të parë Kozma Naska, i cili hyri në oborrin e "Shkollës së kuqe" ku ishte vendosur një repart i Regjimentit Kosovar të drejtuar nga Xhafer Deva dhe i shpartalloi... Ky aksion tronditi thellë kundërshtarët dhe entuziazmoi opinionin e popullit të Tiranës, rriti më tej besimin e tij te populli dhe krijoi bindjen se vetëm partizanët, bijtë e tij, do të sjellin çlirimin e kryeqytetit dhe gjithë Shqipërisë.

Brigada II Sulmuese kalo vështirësi e peripeci të ndryshme, të diktuar nga kushtet e motit dhe të agresioni i tmerrshëm armik kundër dhe u shpërnda, po nuk ja ulin aspak lavdinë. Ajo u shpërnda për t'u riorganizuar në Korçë. Me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm Brigada II, në pranverën e vitit 1944, kaloi nga Shqipëria e Mesme në Qarkun e Korçës ku u plotësua dhe u riorganizua me forca të reja. Në qarkun e Korçës Brigada u dyfishuan: nga 600 në 1400 parti-

zanë, pjesa më e madhe ishin të rinj, që i dhanë gjallëri të madhe Brigadës, sollën freski, trimëri e guxim rinor. Kjo bëri që në aksionet e njëpasnjëshme luftarake që pasuan njëri-tjetrit të kishte me shumë rini dhe vetëm fitore. Janë ta paharruara luftimet në Qafën e Qarrit, Devoll, Bozhigrad, Vithkuq, në fushën e Korçës, në Pojan e Zëmlak etj.. Në këto zona për gati 6 muaj me radhë partizanët e Brigadës II, së bashku me njësitet guerile të fshatrave i dhanë goditje të fuqishme e të pandërprera forcave gjermane të përqendruara në qytete dhe në garnizone të fortifikuara. Një nga aksionet e suksesshme të Brigadës që ai i 17 shtatorit 1944 ku në bashkëpunim me batalionin "Skënder Çaçi", në afërsi të fshatit Dëshnicë, sulmuan forcat gjermane që ishin përqendruar në garnizonin e Korçës. Aksioni ishte i fuqishëm dhe krijoi panik te nazistët të cilët nga zjarri partizan u shpartalluan dhe u tërhoqën.

Gjatë muajve shtator-tetor partizanët e Brigadës II çliruan Leskovikun, Ersekën, Bilishtin. Në bashkëpunim me Brigadën IX S dhe një batalion të Brigadës XX S çliruan Korçën më 24 tetor 1944. Luftimet për çlirimin e qytetit të Korçës vazhduan tri ditë e tri netë rresht. Në këtë aksion forcat naziste e bashkëpunëtorët e tyre pësuan dëme të mëdha.

Pas çlirimit të Korçës brigada vazhdoi aksionet për ndjekjen e forcave gjermane gjatë rrugës Strugë, Qafë Thanë, Përrenjas, Hotolisht, Librazhd etj. Në aksionet e shumta përgjatë kësaj rruge pësoi dëme në njerëz e materiale luftarake.

Në të gjitha këto aksione brigada diti të koordinojë mirë bashkëpunimin me popullin, rininë e forcat e terrenit, ku jo vetëm shpartalloi armiqtë dhe reaksionin, por luajti një rol të madh në ngritjen e Këshillave NAÇ dhe në propagandimin e LANÇ, si e vetmja mundësi për çlirimin e vendit.

Brigada II S u rreshtua në Divizionin VI S së bashku me Brigadën IX dhe Brigadën XX duke marrë pjesë në Korpusin II dhe pas çlirimit të vendit në Korpusin II me qendër në Berat. Familja e madhe partizane e brigadës u kthye në një shkollë edhe për edukimin ushtarak e edukimin e përgjithshëm moral-politik të partizanëve. Ishte kjo familje partizane që ngriti lart frymën patriotike e atdhetare. Midis partizanëve lindi dhe u kalit ndenja e solidaritetit, kolektivitetit e sakrificës dhe miqësisë. Partizanët ndanin me njëri-tjetrin edhe kafshatën e gojës.

Sot, në 82 vjetorin e Brigadës së tyre partizanët që janë gjallë, bashkë me pasardhësit e veteranëve përulen me respekt ndaj asaj lufte heroike për çlirimin e Atdheut, përulen para gjakut e veprës së 43 partizanëve e partizanëve të kësaj brigade që ranë në fushën e betejës si për të mos vdekur kurrë si: Heroi i Popullit Kozma Naska, Besim Imami, Alqi Kondi, Shejnaze Juka, Kostandina Gaçe, Neshat Kondi, Kleanthi Manastirliu, Nazmi Gaba, Raqi Themeli, Sul Misiri, Lllazar Mango, Jaçe Hormova, Ymer Demiri etj.

LANÇ është një nga vlerat më të shkëlqyera të historisë së popullit tonë, është e papërsëritshme dhe e patjetërsueshme. Ajo Luftë që e lidhi popullin tonë me aleatët më të mëdhenj të koalicionit antifashist të Luftës II Botërore, është vlerësuar me notën shkëlqyeshme nga gjithë shtetet e popujt progresistë që luftuan kundër murtajës nazifashiste.

Kushdo që guxon të hedhë baltë mbi LANÇ, të bëjë histori mbi histori nuk ja arrin dot. Historia nuk kthehet pas. Ajo është shtruar njëherë e përgjithmonë. Le ta mësojë brezi më i ri i vendit, se me gënjeshtër e hipokrizi nuk ka histori. Historia e vërtetë është e partizanëve dhe jo e ballistëve që u shitën të fashizmi e shitën Shqipërinë ashtu siç po bëjnë edhe sot.

95-VJETORI I DITËLINDJES

Org. Bashkuar e Veteranëve të LANÇ dhe Pasardhësve, mesazh urimi për Prof. Hakon

HULUSI HAKO, GATI NJË SHEKULL KUJTESË DHE QËNDRESË. DITËLINDJA E VEÇANTË E NJË DËSHMITARI TË HISTORISË

Nga Pano Hallko

...Në orën e caktuar sipas takimeve që ka lënë, me skrupulozitetin e një nëpunësi teknokrat, i cili kushedi se kur do të (ri) duket në këtë shtet, ai ndodhet në tavolinë, në Misionin e tij si Kryetar i Organizatës së Veteranëve të LANÇ. Nis kështu, në mëngjesin e çdo dite “që ka falur zoti”, një luftë-vija e frontit të së cilës është në gjatësi fizike 95 vjeçare...

Shikimi i tij teksta të flet, tretet diku larg edhe kur ndodhesh vetëm një metër larg tij, zëri i buçet në bisedë e sipër, jo rrallë shpërthen kundër padrejtësive që ka parë e përjetuar në këtë vend gjatë... plot 95 viteve!

Për ata që e njohin nga afër, mund të përcaktohet edhe si përrjashtëm biologjik, pasi njëri nga parametrat kryesorë të njeriut, te profesor Hulusi Hako, pra Kujtesa, ecën kundër ligjeve të natyrës dhe në përpjesëtim të zhdrejtë me parametrat e tjerë.

Kujtesa e tij-pa e tepruar aspak do të thoshim e rrallë për realitetin shqiptar, nuk do t'ia dijë për datëlindjen e largët të tij, përkundrazi, ajo “mprehët”, në “kai-shin” e madh e të pafund të kohës, freskohet vazhdimisht, kushedi se në çfarë mënyre të rigjenerimit të neuroneve, rend ndër vite, deri në historinë e luftërave të padrejta që i imponuan kombit tonë.

Meqenëse shkruesi i këtyre radhëve bën pjesë ndër ata që patën fatin ta kishin pedagog në kohën kur në këtë vend bëhej shkollë, nuk mund të mos ta uronë sot, publikisht, në jubileun e 95-të të datëlindjes së tij.

Profesor Hulusi Hako përbën sot, pa asnjë lloj zmadhimi një pasuri kombëtare, një kapital të patundshëm, e pse jo, edhe një pikë reference për krenarinë kombëtare, në të gjithë hapësirën shqiptare...

Më 20 Tetor 2025 Hulusi Hako mbush 95 vjeç. E veçanta e tij qëndron në faktin se është ndër të rrallët personalitete shqiptare, i cili ka jetuar në katër regjime të ndryshme. Edhe sikur ai të ishte “njëri nga ne të tjerët”-sa i takon mençurisë dhe potencialit intelektual, si dëshmitar okular e përjetues i kthesave më dramatike që ka përshkuar kombi ynë qysh pas shpalljes së Pavarësisë e gjer më sot, ai-ve-tiu e pa diskutim, do të ishte “Monument Natyre” e duhej të mbrohej nga shteti-të cilit kushedi se kur do t'ia shohim fotografinë në kuptimin e sipërpërmendur.

Nuk ka rëndësi se ku lind një djalë shqiptar, në buzën e detit, apo në fushën e Myzeqesë, në Bjeshkët e larta, apo në vende kodrinore-malore si Delvina. Geni i fuqishëm trashëgon në mënyrë besnike gjithçka të mirë dhe e transmeton me të njëjtën besnikëri në brezat pasardhës.

Thuhet kjo, sepse në kushte të tjera e vende të tjera, do të ishte si “parakusht” që një njeri i cili në jetën e tij do jepte kaq kontribute shoqërore, shkencore dhe intelektuale, “duhej të kishte lindur, e vitet e vegjëlisë dhe të adoleshencës, t'i kishte kaluar në një shtëpi mondane me libra të shumtë e të rëndë nga pesha e kapakëve të lëkurës”, etj. etj. si këto.

Me shqiptarët nuk ndodh kështu, pra nuk është i vlefshëm ky parakusht. Edhe kur djali lind në majë të malit apo buzë një lumi, Kodi i veçantë që kanë kombet në transmetimin e tipareve, ndërmjet sinjaleve të tjera i çon në vesh e në mendje dhe mëpastaj u jep misionin e tyre në fushën e duhur, shoqëruar edhe me “detyrën” për të...gjatëjetuar!

Profesorit, iu ngarkua misioni për të qenë një mësues i madh, e një veprimtar shoqëror i rrallë. Mision, të cilin ai po



e kryen përditë, si pak të tjerë dhe me përpikëri e fuqi shpirtërore të rrallë.

ME PUSHKË, E...

Më datën 8 të këtij muaji, gazeta “Dita” siç ishte në nderin e saj, botoi një shkrim të tjetërllotë me firmën e profesor Hulusi Hakos. Me titullin “Të festojmë, duke mos harruar”. Ishte ky shkrim shumëplanësh për luftën e bërë për çlirimin e Delvinës dhe Sarandës.

Aq sa ishte një kujtesë e përmbledhur e ngjarjeve dhe një Homazh i shkëlqyer për të rënë në atë luftë, po aq, ishte edhe thirrje e përmbledhur për shtetin dhe për shoqërinë shqiptare. Një thirrje, në kushtet ku ndodhet bota sot, e doemos Shqipëria.

Besoj se kur ka nënvizuar “duke mos harruar”, ai ka pasur parasysh disa raste në historinë tonë të largët...

Në Betejën e Pelionit në vitin 335 p.e.s. që e ka përshkruar në mënyrë të shkëlqyer Akademik Neritan Ceka, biri i Bardhylit-Kliti, luftonte me trupat e Aleksandrit diku në malësitë e Pogradecit, në Pelion. I thyen kundërshtarët bijtë e Shqipës, e armiku u largua. Por Aleksandri që nuk ishte edhe aq “i largët” në breza fisnorë me ta, u tha vartësve të tij: -Shkoni përsëri atje mbas 24 orësh, se do ta keni të lehtë, pasi do t'i gjeni duke festuar”. Armiku erdhi, i gjeti duke festuar, e i përzuri shqiptarët nga vija që mbronin këta tanët.

Po kështu edhe në Berat me otomanët, pasi forcat e Skënderbeut i thyen armiqtë, e njëjta gjë ndodhi. Kuptohet, Skënderbeu ndodhej në Krujë dhe i porositi komandantët që nisi atje: “Kujdes pas betejës, se e di që do fitoni”... Po ku mbahemi ne, kur fitojmë? Ia nisim “betejës” me verën (atëherë kishte plot nga ajo e uruar, pa sot pijmë “verë” pa kartë identiteti dhe.. e pagëzojmë “verë Lundre”, e prodhuar nga vreshtat që u shkullën para 25 vitesh, e u mbollën vilat në atë vend...

Profesori i nderuar, jepte me finesë mesazhet e tij për politikën, doemos mesazhe për ushtarakët, kur përmendte komandantin e postës së Sarandës në 7 Prill të vitit 1939...

I jepte këto mesazhe, sepse ai e përjetoi luftën, madje duke luftuar edhe ai, në kushtet dhe moshën që kishte.

Ndoshta do ishte mirë, që link-u i atij shkrimi të ishte në rrjetet e shumta që na marrin frymën me njëmijë e ca...“lajme”!

ME PENË...

Personalitete të këtyre përmasave, kanë të drejtën t'i shikojnë të gjithë drejt

në sy, sepse janë misionarë që nuk dinë të pushojnë së përpjekuri dhe luftuari, në fushën e edukimit dhe të ruajtjes së vlerave të larta njerëzore, shoqërore dhe kombëtare.

Profesori prodhoi vepër të madhe edukative dhe kombëtare në shërbim të edukimit të brezave.

Tridhjetë e pesë vite pedagog, ai ka lënë gjurmë të pashlyeshme në brezat e studentëve që kanë kaluar në auditorë. Një ligjërues i rrallë e me sqimë i Shqipës.

Mbresat më të fuqishme në shkollimin e tij, ai i përjetoi në gjimnazin e Gjirokastër “Asim Zeneli”. Kanë mbetur në kujtesën e njerëzve fjalët e tij të urimit para gjimnazit, në 100 vjetorin e asaj shkolle: -“Këto klasa janë 100 vjeçare. Por vetë gjimnazi, është 20 vjeç, është aq vjeç sa isha unë, kur u diplomova këtu. Është aq vjeç, sa janë maturantët e tij të sivjetmë”...

Ai ishte bashkënxënës me Dritëroin e madh. Qysh kur ishte në bankat e asaj shkolle, atij iu ngarkua të mbulonte aktivitetet kulturore. E jo vetëm në gjimnaz, por në gjithë fshatrat e rrethit, fshatrat e atyre viteve... Dhe ai shkëlqeu.

Në vitet e para të së ashtuquajturës demokraci allashqiptarçe, profesorin e sulmoi vulgu i këtij vendi, se ai na paskej cenuar besimet fetare me librat e tij. Do ishte e pa vend, të merremi me këtë “krim” që paska bërë ai, e mjafton të sjellim vetëm një shembull.

Dikur, në mesvitet '70-të, në sezonin e provimit në Universitet, shkon përpara komisionit për t'u përgjigjur, një vajzë, të parët e së cilës i takonin besimet katolik.

Vajza u përgjigj relativisht mirë në pyetjen “Roli i feve në Shqipëri”.

Dhe u vlerësua nga komisioni, me notë të mirë. Mbasi mori librezën e notave në dorë, vajza duke u ngritur, i drejtohet profesor Hulusiut: -“Profesor, a mundem të vij t'ju them diçka nga afër”? -Patjetër, ia pret ky. Dhe studentja i thotë në vesh me zë të ulët: -Profesor, unë e kam mësuar për notë lëndën, por në fakt besoj”...

Profesori u ngrit në këmbë, e përqafoi dhe i tha me zë të lartë: -“Vazhdo të besosh, bija ime. Nuk është faji yt, ky fakt. Është pa aftësia ime, që nuk të binda dot, për të kundërtën”...

Ja pra, ky ishte ateisti që “vrau dhe preu” në këtë vend!

Leksionin e parë të ateistit, ai e mësoi nga nëna e tij, në vitet '30-të të shekullit të kaluar, në moshën 7 vjeç, teksa dëgjonte nënën, kur thoshte:

-“Do hamë për darkë, ç'të na japë xhiko perëndia”. Por dominues në gjykimin e saj, ka qenë skepticizmi i shfaqur me



arsyetimet: “Gjithë këto vuajtje, sëmuren dhe vdesin fëmijë, bëhen luftëra e padrejtësi, ku është ky zoti, që nuk ndërhyjnë dhe nuk vë dorë?”

Citohet ky çast nga Kujtimet e profesorit, për të treguar një fakt të madh. Që ateizmin, e kryesisht skepticizmin për besimet fetare, shqiptarëve nuk ua solli Hulusi Hako. Ai “e gjeti mes tyre” dhe thjesht e vendosi në shinat e shkencës, e në logjikën e shëndoshë...

Janë të shumtë librat e profesorit edhe pas viteve '90-të. Besoj se e vlen të veçohet libri i tij me titull “Kosova-ëndrra ime” (Komb-shteti i shqiptarëve, vepër e atdhetarëve të përkushtuar e vizionarë), i botuar në vitin 2012, në kuadrin e 100 vjetorit të Pavarësisë.

Ky njeri me gërmë të madhe, ka rreth tre vite që është në krye të Organizatës së Veteranëve të LANÇ-it. Nga sa ka ndjekur shkruesi i këtyre radhëve nëpër media dhe portale, e vetmja që mbetet të thuhet, është: -Për tani, në këtë moshë, i mbetën vuajtjet këtij njeriu!

Hulusi Hakon do ta kishte për nder ta kishte Kryetar, cilado shoqatë apo organizatë e ngjashme, kudo në botë. Mirëpo nuk ndodh kështu tek ne. Sepse kështu ka ndodhur (që të mos ndodhë ajo që duhet të ndodhë tek ne), ndër kohëra!

Nejse, le t'ua lemë “rivalëve” të padenjë këto, që të mos prishim gëzimin, në këtë datëlindje të 95-të të tij...

Diku në shkrimin e tij të datës 8 të muajit në vazhdim, botuar në këtë gazetë prestigjioze, profesorin nënvizon: -“U linda në luftë dhe e përjetova atë ndjeshëm, në moshën që kuptoja dhe përjetova gjithçka. Përjetova shpirtërisht si padrejtësi, çdo luftë që është bërë në çdo pikë të globit, në vitet që jam në jetë. E si çdo njeri që është në moshë të thyer, do dëshiroja që botën ta lija në paqe. Po ja, që nuk qenka e thënë”...

Edhe pa lejen e tij, me këtë merak që ka, jam qartazi kundër. Sepse profesori nuk ka dijeni për një fakt që ka ndodhur; Është bërë marrëveshje mes Kodit të tij gjenetik dhe gjithë shenjtoreve të të gjitha feve dhe imamëve, një Marrëveshje në të cilën është vendosur, se...Profesor Hulusi Hako, do jetojë gjatë!

Kështu që mund të ndodhë, që ai ta shikojë dhe ta lerë botën, në paqe të plotë. Pse jo? Ekziston një kohë, kur njerëzit mund të bëhen të mirë e të drejtë. Por kjo është në fuqi edhe për popujt, kombet, shtetet, kontinentet, për gjithë botën...

Jetëgjatë dhe mendje të freskët, i nderuar Profesor!

DOSSIER

“Fadil Hoxha, siç e njoh unë”, LIBRI I EKREM MURTEZAIT

Jeta dhe veprimtaria e njërit prej njerëzve më kontrovers në Kosovë, ish – liderit komunist Fadil Hoxha, vazhdon edhe sot e kësaj dite të qëndrojë e mbështjellë me një hije misterioze. Janë shkruar libra dhe shkrime të ndryshme lidhur me këtë figurë, shumica e të cilave janë ose pro ose kundër tij. Filozofi i njohur kosovar Ekrem Murtezai, i cili për rreth pesë vite (1979–1984), ka qenë edhe shef i kabinetit dhe njëkohësisht këshilltar i Fadil Hoxhës, kur ky ishte anëtar i Byrosë Ekzekutive, që ishte pika më e lartë në karrierën e tij politike, ka vendosur që të hedhë në letër mendimet e tij mbi Fadil Hoxhën dhe përvojën e tij si bashkëpunëtor i afërt i udhëheqësit komunist.

Në librin me titull “Fadil Hoxha, siç e njoh unë”, libër ky që do të dalë nga botimi pas disa muajve, pasi që Murtezai ende nuk e ka përfunduar, tentohet që të vihet një balancë në qëndrimet e ndryshme mbi ish – udhëheqësin komunist.

Ai shprehet për ‘Expres’ se Fadil Hoxha, apo si e quan Murtezai, “komandanti i Ushtrisë Nacional-Çlirimtare dhe organizatori” i asaj që mund të quhet kryengritje apo revolucion i masave shqiptare të Kosovës, është figurë markante, e cila nuk mund të anashkalohet për askënd që ka aspirata ta shkruajë historinë më të re të Kosovës.

“Si njeri prej bashkëpunëtorëve më të ngushtë të kryetarit të Jugosllavisë Josip Broz Tito, Fadil Hoxha është padyshim një figurë kontroverze. Ky karakter kontrovers i personalitetit të tij rrjedh, përveç tjerash, edhe nga fakti se veprimtaria e tij është shtrirë në shumë fusha në një territor që përfshin jo veç Kosovën e sotshme, por edhe më gjerë, deri edhe në pjesën veriore të Shqipërisë”, – vlerëson filozofi Murtezai, i cili është edhe anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës.

Sipas tij, ky karakter kontrovers i Fadil Hoxhës, rrjedh edhe nga fakti se gjatë periudhave të ndryshme të zhvillimit shoqëror-politik të Kosovës e, së bashku me Kosovën edhe të ish-Jugosllavisë, ka pasur pozicionime të ndryshme, të cilat i japin mundësi ithtarëve dhe dashamirëve të tij, të flasin në mënyrë supremative për Fadil Hoxhën, si njeri, si politikan, si veprimtar, si shqiptar, por pse jo edhe si komunist.

Murtezai thekson se kundërshtarët e Hoxhës e mohojnë atë që është kryesore për të, që sipas Murtezait, është karakteri patriotik i veprimtarisë së Fadil Hoxhës dhe pikëpamjeve të tij.


“Karakterin patriotik të Fadil Hoxhës, madhësinë e tij, e nxjerr nga fakti se brenda përbrenda ideologjisë komuniste, politikës socialiste, brenda përbrenda asaj që ai i ka takuar, atij establishmenti, asaj strukture sociale politike, e baza e së cilës ka qenë internacionalizmi, Fadil Hoxha prore ia ka dalë me sukses që ta paraqes,

ta mbrojë dhe ta avancojë kauzën e shqiptarëve të Kosovës, por edhe të shqiptarëve jashtë Kosovës, atyre në Luginën e Preshevës dhe në Maqedoni, ku shqiptarët siç dihet mirëfilli, atje nuk kishin gati kurrfarë të drejta”, – pohon akademiku Murtezai.

Në veprën “Fadil Hoxha, siç e njoh unë”, theksi vihet në paraqitjen e atyre të dhënave, e atyre fakteve, të cilat janë më pak të njohura për opinionin e gjerë. Duke qenë bashkëpunëtor i Titos, anëtar i Byrosë Ekzekutive, kryetar i Kuvendit të Kosovës, kryetar i Këshil-

bashkimi me Shqipërinë, por që nuk u arrit kurrë një gjë e tillë.

Murtezai tregon se Fadil Hoxha ishte takuar për herë të parë me Titon në Leskovc, atëherë kur çështja e raporteve midis Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë, ishte ashpërsuar deri në maksimum dhe Jugosllavisë i kanosej rreziku i sulmit nga ana e Bashkimit Sovjetik. “Kur u zgjodh anëtar i Byrosë Ekzekutive në Kongresin e madh në vitin 1969 e, deri me vdekjen e Titos, Fadil Hoxha ka qenë bashkëpunëtor i ngushtë i Titos, marrëdhëniet kanë



lit Ekzekutiv të Kosovës, komandant i Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, Fadil Hoxha, sipas Murtezait, gjithmonë në fokus të vëmendjes së tij dhe veprimtarisë politike e ka pasur kauzën e shqiptarëve, kauzën e kombit, gjë që Murtezai këtë tenton ta dëshmojë me ato fakte që i ka të njohura.

Murtezai gjithashtu flet edhe për Konferencën e Bujanit dhe rolin e Fadil Hoxhës në këtë konferencë, pastaj për dobësitë dhe vlerat e personalitetit të tij, e po ashtu edhe për raportet e tij me dy udhëheqësit komunist të asaj kohe, Josip Broz Tito dhe Enver Hoxha.

“Çështja e Konferencës së Bujanit është e pashmangshme, nuk mund të anashkalohet as Bujani prej Fadil Hoxhës e, as Fadil Hoxha nga Konferenca. Është e vërtetë se aty kanë qenë shkruar të rezolutës Hajdar Dushi, Zeqirja Rexha dhe të tjerë, por me sa di unë, nga biseda që kam pasur me të dhe nga ajo që kam lexuar, del se Fadil Hoxha ka qenë ‘Spiritus Movens’, ka qenë ai shpirti lëvizës, ajo fryma e gjallë që i ka dhënë determinantat kryesore se si të shtjellohet dhe formulohet rezoluta e Konferencës së Bujanit”, – shprehet Murtezai për konferencën, në të cilën porosia kryesore ka qenë vetëvendosja e shqiptarëve të Kosovës dhe

qenë të afërta.

Personalisht mund të dëshmoj me përgjegjësi të plotë se për shumë çështje lidhur me politikën jugosllave e veçanërisht me politikën e Lidhjes së Komunistëve dhe të qeverisë jugosllave ndaj Kosovës, Titoja është konsultuar me Fadil Hoxhën”, thekson Murtezai.

Ndërkaq, kur flet për marrëdhëniet e Fadil Hoxhës me Partinë Komuniste të Shqipërisë dhe me Enver Hoxhën, Murtezai pohon se kur Partia Komuniste Jugosllave filloi t’i tradhtojë parimet mbi të cilat ishte formuar Ushtria Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe kur plasi lufta në Drenicë dhe të tjera raste që dëshmonin se kauza shqiptare nuk është duke shkuar si duhet, Fadil Hoxha ka shkuar incognito te Enver Hoxha dhe i është ankuar për gjendjen e keqe, të padëshirueshme dhe të papritur të shqiptarëve.

“Fatkeqësisht nuk dihet kush, a Enver Hoxha apo Koci Xoxe, apo të dy, apo vetëm njeri e kanë denoncuar Fadil Hoxhën te OZNA e Jugosllavisë, e kanë lajmëruar kryepolicin e atëherëshëm Aleksandër Ranković, kurse ky e ka lajmëruar edhe një polic të egër antishqiptar, i cili erdhi në Prishtinë dhe e mori në pyetje Fadilin”, pohon ai.

Pas rezolutës së Informbyrosë në

• *“Nuk dihet nëse Enver Hoxha apo Koci Xoxe e denoncuan Fadil Hoxhën te policia sekrete e Jugosllavisë”- Çfarë thuhet në librin e ish-shefit të kabinetit: Ministri i Brendshëm Ranković e mori në pyetje dhe...*

vitin 1948, kur marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë erdhën e u keqësuan, sipas Murtezait, Fadil Hoxha tërhiqet dhe nuk jep shenja të animimit kah Enver Hoxha dhe Partia Komuniste e Shqipërisë, ani pse, sipas fjalëve të tij, një kohë të gjatë është luhatur, ka hezituuar cilën anë ta marrë, atë të Titos apo të Stalinit.

“Pasi që ka përsiatuar rreth dy muaj, ka vendosur të përcaktohet për Titon dhe kjo automatikisht do të thotë; jo me Enver Hoxhën, jo me Partinë Komuniste të Shqipërisë dhe për këtë Enver Hoxha e akuzon Fadilin si titist”, thekson Murtezai.

Libri i Murtezait, siç pohon ai, ka për qëllim që të tregojë se Fadil Hoxha me gjithë dobësitë që janë shfaqur qoftë si personalitet, qoftë për arsye të sistemit në krye të të cilit ka qenë ai, prapëseprapë mbetet një shqiptar i ndershëm, një njeri që jetën e vet e ka vu në shërbim të popullit.

Libri që tenton të nxjerrë në pah të vërtetën rreth Fadil Hoxhës, sipas autorit Ekrem Murtezai, do të shfaqë vlerat dhe dobësitë e ish udhëheqësit komunist dhe në këtë mënyrë do të balancojë mendimet kundërtëne që janë shfaqur deri me tani rreth personalitetit të Hoxhës.

*/ Memorie.al/
Nga Ekrem Murtezai*

LIBRI

Si e eliminoi diktatori Presidentin e parë shqiptar të pas Luftës së Dytë Botërore. Misteret e vdekjes së Omer Nishanit

OMER NISHANI – JETA E NJË PRESIDENTI

HALIL RAMA *MJESHTËR I MADH

Historia e vendit tonë është shumë e ngarkuar me ngjarje të ndryshme. Atë e shkruajnë jo vetëm studiues e historianë të mirëfilltë, por kushdo që ka për të treguar ngjarje që mbartin vlera historike. Njëri nga këta shkruar të historisë tonë kombëtare është edhe intelektual i përmasave shumëdimensionale, Tomson Nishani, i cili me botimin e librit “Jeta e një Presidenti” (kushtuar Omer Nishanit), synon t’i shërbejë historisë së kombit. Këtë mision, Tomson Nishani (botuesi i disa librave si dhe i artikujve të shumtë të natyrës profesionale dhe propagandistike për kopshtarinë e vendit tonë, por edhe të natyrës historikoshoqërore) e përmbush më së miri edhe me këtë libër, duke folur për jetën e një presidenti, për të cilin dokumentet e publikuara nuk janë të shumtë.

I ndarë nga jeta para 10 vitesh, autori i këtij libri na la si “testament” biografik e ish-Presidentit të Republikës së Shqipërisë, dr. Omer Nishani, i cili jetoi vetëm tetë vjet, (nga viti 1946-1954), pas çlirimit të vendit tonë nga okupatorët nazifashistë. Por që ndonëse e gjithë jeta e tij ishte vënë në funksion për të ideuar diçka të dobishme për Shqipërinë, në ceremoninë e varrimit të tij, pasi e kishin detyruar të dorëhiqej, qeveria komuniste e asaj kohe nuk pranoi të thërriste as bashkëshorten dhe asnjë nga njerëzit e vëllait të tij.

DOKUMENTI I PASHFLETUAR

Autori i këtij libri bën të ditur se për aktivitetin e dr.Omer Nishanit, në Arkivin Qendror të Shtetit, ka një dokumentacion të pasur, por që akoma nuk është shfletuar. Ai u lind më 5 shkurt të vitit 1887, në qytetin e Gjirokastrës, në lagjen e njohur si “Palorto”. Shtëpia e prindërve të tij ishte dykatëshe, e thjeshtë, me disa dhoma, me një kopsht të vogël dhe përpara me një shesh të kalldrëmtë. Pasi mori mësimet e para në qytetin e lindjes, Omeri u nis në Stamboll dhe atje pasi mbaroi shkollën e mesme, fillon studimet për mjekësi.

“Jeta e këtij intelektual ka pasur prirje demokratike, nacionaliste me krah perëndimor, për një vend shqiptar të kulturuar dhe për një shoqëri të civilizuar. Ishte antimonarkist dhe antinazifashist. Në jetën e tij peshonin interesat e atdheut, prandaj ai emigroi dhe më pas u dënua me burgim dhe me vdekje, kështu që nuk mundi të vazhdonte ushtrimin e profesionit të mjekut, i specializuar jashtë vendit”, – shprehet autori i këtij libri në parathënien e tij.

Pasi ka hulumtuar nëpër arkivat e kohës, ai shprehet: “Dr.Omer Nishani, për vite me radhë jetoi jashtë Shqipërisë, në kushtet e një emigracioni të ashpër, ku asnjëherë dhe asnjë pjesë e jetës së tij nuk njohu paqe e qetësi. Kundër preferencave që i bënte qeveria fashiste e asaj kohe, ai zgjodhi udhën e vështirë të luftës me armë në dorë, kundër pushtuesve të huaj nazifashistë”.

Në shtabin e luftës partizane, dr.Omer Nishani tërhoqte vëmendjen me veshjen e tij. Një kostum ceremonial, me kravatë dhe me “kapele republike”, rrallë herë veç me këmbë të bardhë dhe në duar një pardesy të zakonshme. Ai vinte nga një karrierë e madhe politike, ku kohën më të madhe të emigracionit e kishte kaluar nëpër vendet më të civilizuar të Europës, në Zvicër dhe Austri.

NGA SHTABI I LUFTËS

Në përshtypjet që kishte për Omer Nishanin, zonja e dr.Ymer Dishnicës, shprehet se kur gjendej shpesh në shtabin partizan, midis drejtuesve të lartë, përveç kostumit që mbante veshur, të binte në sy mënyra e sjelljes së tij që ishte tepër shembullore. Që në fjalët e para kuptojë se kishte të bëjë



me një burrë shumë të kulturuar, që i donte dhe respektonte njerëzit. Dr.Omer Nishani mbetet një figurë tepër e njohur në prag të çlirimit të vendit nga nazifashistët. Në Kongresin e Përmetit në vitin 1944, ai do të shprehej se “Historia ka treguar se kemi dashur një Shqipëri më vete, të pavarur dhe të kundërt me nazifashistët dhe bashkëpunëtorët e tyre”. Në një fjalim tjetër, ai vlerëson fitoret e aleatëve kundër aleancës nazifashiste, sidomos zbarkimin e aleatëve perëndimorë në Normandi të Francës. Dr.Omer Nishani, sipas bindjeve të tij, në këtë fjalim të mbajtur në Berat, shpreh hapur mendimin se tashmë jemi qeveri demokratike.

Si forcë shoqërore lëvizëse, dr.Omer Nishani, në një takim tjetër me gruan antifashiste shqiptare, e vlerëson atë për kontributin e çmuar që dha në Luftën nacionalçlirimtare. Ai vlerëson gjithashtu forcën e vajzave dhe grave shqiptare, si thyese apo shkatërruese të zakoneve të vjetra shekullore të trashëguara nga qeverisjet e mëparshme.

Në vitin 1945 është botuar një broshurë me fjalimet, kryesisht të dr.Omer Nishanit, ku përmbajtja e atyre referimeve ka natyrë progresiste, të moderuar dhe shumë emancipuese.

KUSH ISHTE OMER NISHANI

Omer Nishani ka lindur më 1887. Ka qenë diplomuar për mjekësi në Turqi. Më 1914 ka shërbyer mjek në batalionin e Gjirokastrës, vit kur edhe dërgohet nga qeveria në Vjenë për t’u praktikuar si mjek ndër klinikat e atjeshme. Kthehet nga atje në vitin 1915 ku për tre vitet në vijim deri më 1918 shërbeu si doktor i bashkisë së Ballshit në varësi të Prefekturës së Beratit. Në vitet 1920 –24 ka ushtruar profesionin e mjekut në spitalet e Tiranës dhe të Durrësit, por largohet nga vendi pas dështimit të qeverisë të Fan Nolit në dhjetor 1924. Në fillim të vitit 1924 burgoset për dy jave për shkak të pjesëmarrjes në atentatin ndaj Mbretit Ahmet Zogu në parlament. Në dhjetor 1924 largohet nga Shqipëria për në Itali e më pas në Austri.

Në Vjenë më 1925 ka qenë bashkëthemelues i Komitetit Nacional Revolucionar (KONARE).

Omer Nishani, më 1926 ka qenë drejtor i

gazetës “Liria Kombëtare” në Gjenevë. Emri i tij shënohej në krye të gazetës deri më 22 korrik 1932, më pas nuk shkruhej se kush e drejtonte. Në harkun kohor të gjashtë viteve (1933-1939) dr. Omer Nishani ishte emigrant politik në Zante të Greqisë. Kthehet në atdhe pas pushtimit fashist të vendit.

Më 1940 u zgjodh anëtar të Këshillit të shtetit, funksion të cilin e mbajti deri më 13 janar 1944, ndonëse që në gusht 1943 kishte kaluar me radhë e Frontit dhe në Konferencën e Labinotit (1943) zgjidhet anëtar i Këshillit të Përgjithshëm Antifashist Nacionalçlirimtar.

Në kongresin e Përmetit të majit 1944, Omer Nishani u zgjodh kryetar i Këshillit Antifashist Nacional Çlirimtar. Njëkohësisht në Komitetin Antifashist Nacional Çlirimtar që kryesohej nga Enver Hoxha në tetor 1944, Omer Nishani mori postin e ministrit të Punëve të Jashtme, detyrë që e ushtroi deri më 9 shkurt 1946.

Në zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945, u zgjodh deputet i Gjirokastrës. Më 12 janar 1946, pasi Shqipëria ishte shpallur republikë, Nishani u zgjodh President i Presidiumit të Kuvendit Popullor, funksion që e mbajti deri më 31 korrik 1953. Ai u zgjodh sërish deputet i Gjirokastrës në Kuvendin Popullor, të dalë nga zgjedhjet e datës 28 maj 1950.

Omer Nishani ka vdekur në 25 maj 1954. Sipas një dosje të Ministrisë së Brendshme, autopsia e kryer vërteton se Nishani ishte vetëvrarë, ndonëse sipas një dëshmie që vranë nga djali i një ish-ekspONENTI kryesor të qeverisë së asaj kohe. Qeveria shqiptare e asaj kohe, ceremoninë e varrimit e përqendroi në vetvete. Nuk pranoi të thërriste as bashkëshorten e dr.Omer Nishanit dhe asnjë nga njerëzit e vëllait të tij. Më 27 maj 1954, gazetat e përditshme “Zëri i Popullit” dhe “Bashkimi” njoftonin shumë shkurt vdekjen e Nishanit në moshën 67-vjeçare “pas një sëmundje të rëndë”. Më 13 tetor 1989, spitalit të Gjirokastrës do t’i vihej emri i tij.

DORËHEQJA E DETYRUAR

Omer Nishani ishte politikan shqiptar i pas Luftës së Dytë Botërore, ministër i Punëve të Jashtme i Shqipërisë dhe kryetar i presidiumit të Kuvendit Popullor, që në atë kohë mbante edhe postin e kryetarit të shtetit. Dr. Omer Nishanit gjatë viteve të sundimit social-komunist iu desh të përballej me të tjera vështirësi, të cilat ndikuan në vitet e fundit të jetës së tij, kur mbeti i izoluar, i trishtuar deri sa mbylli jetën.

Është e vërtetë se Omer Nishani ishte i sëmurë rëndë, por është po kaq e vërtetë se para vdekjes, vrasjes apo vetëvrasjes së tij, Enver Hoxha e kishte larguar atë nga tribuna kryesore e podiumit të Kuvendit Popullor. Është po kaq e vërtetë se dy ditë pas vdekjes, vrasjes apo vetëvrasjes së Omer Nishanit do të bëheshin zgjedhjet për Kuvendin Popullor dhe Omer Nishani nuk ishte propozuar si kandidat për deputet. Është po kaq e vërtetë se Enver Hoxha e kishte detyruar më parë Omer Nishanin që të jepte dorëheqjen si kryetar i Presidiumit të Kuvendit Popullor, gjë që ai e bëri më 1 gusht 1953. Sikur të mos mjaftonin këto, “shokët e tij të luftës” kërkuan ta nxjerrin edhe jashtë shtetësisë ku banonte. Sigurimi i Shtetit kishte nisur ndërkohë edhe përgjimin sistematik të jetës së tij të ngushtë private, gjë që nuk mund të bëhej kursesi pa një urdhër nga lart. Në këto kushte, mundet që Omer Nishani e ka ndjerë veten të poshtëruar, të zhgënjyer dhe ka vranë veten. Megjithatë dr. Omer Nishani ka më shumë se gjysmë shekulli që është ndarë nga jeta, veprimtaria e tij mbetet jetësore.

Në mongrafinë “Jeta e një Presidenti”, autori i saj arrin të portretizojë me mjeshtri këtë figurë shumëdimensionale, si intelektual, politolog, publicist dhe drejtues i talentuar.

DOSSIER

Me porosi të Enver Hoxhës dënohët me 6 vjet heqje lirie me akuzën “agjitacion e propagandë”



HISTORIA E TRISHTË E DR. YMER DISHNICËS



Ymer Dishnica (1912-1992), ka qenë një nga figurat më simpatike, më të mençura, më fisnike dhe një nga udhëheqësit kryesorë të Partisë Komuniste Shqiptare dhe Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare. Ai u lind në fshatin Dishnicë më 21.2.1912, 4 km. afër qytetit të Korçës. Ymer Dishnica është moshatar me pavarësisë kombëtare dhe është bir i denjë i një familje me tradita të shquara atdhetare, e cila i ka dhënë Shqipërisë pesë dëshmorë, përfshi edhe një vëlla të doktor Ymer Dishnicës. Ai është një nga veprimtarët më të shquar antifashistë frankofonë të Shqipërisë. Njerëzit si Ymer Dishnica kishin cilësi të ralla kulturore, komunikative e propagandistike bindëse. Ai ishte i aftë të bisedonte bindshëm me njerëz të natyrave dhe karaktereve të ndryshme.

I edukuar në një ambient fshatar por edhe qytetar si Korça, apo Evropian si Parisi dhe Franca, kishte aftësi bindëse të çuditshme. Agjitor i jashtëzakonshëm i tipit të ri antifashist, Ymeri e kuptonte me lehtësi hallehiun nga fshati, qyteti apo aleatët e huaj.

Ai nuk ishte njeri i nënshtruar dhe nuk ndjente komplekse inferioriteti ndaj askujt, sidomos ndaj përfaqësuesve të aleatëve. Me përfaqësuesit e forcave kundërshtarë të djathta, doktor Ymeri bisedonte pa kërcënime dhe fyerje dhe ishte në gjendje të kuptonte kompromisin nga nënshtrimi.

Ministri i Shëndetësisë i qeverisë të parë demokratike shqiptare. Anëtar i Komitetit Qendror dhe Byrosë Politike të PKSh-së, anëtari Këshillit të Përgjithshëm Antifashist Nacional Çlirimtar. Besnik i kauzës antifashiste dhe komuniste e bindjeve të tij të cilat, i kishte përqaftuar që shumë kohë para formimit të PKSh-së, kur ndodhej në Francë.

Ky personalitet i shquar i kapaciteteve të mëdha, i kalonte përmasat e Shqipërisë, me integritetin e tij intelektual e moral. Më pas, Ymer Dishnicën e përjashtuan nga Komiteti Qendror i PKSh-së e Byroja Politike dhe kështu filloi kalvari i tij i gjatë, i të përndjekurit politik.

Dr Ymer Dishnica më 4.7.1943 në Labinot të Elbasanit, zgjidhet

anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UANÇSh. Arsimin fillor e nisi në vendlindje dhe përfundoi në Korçë, ndërsa arsimin e mesëm me rezultate të shkëlqyera e përfundoi në Liceun kombëtar francez të këtij qyteti (1932). Pas kësaj Ymer Dishnica u nis për në Francë, ku do të studionte për tetë vjet në Universitetin e Lionit dhe më pas atë të Parisit për mjekësi (1932-1941), duke u lauruar e specializuar për patologji.

Ymer Dishnica nga natyra ishte njeri intelektual me kërkesa dhe kapacitete të larta kulturore. Ai në ato vite kurrsesi nuk mund të mos vizitonte Tyleritë dhe muzeumin e famshëm të Luvrit si dhe muzetë e shumtë të Parisit dhe qyteteve të Francës. Arkitekturën klasike dhe moderne të Francës. Ai vizitoi teatrot dhe galeritë e shumta të arteve të “kryeqytetit të botës”.

Paralel me studimet ai nuk mund të mos vizitonte pyjet dhe parqet e rrethinave të Parisit, brigjet e plazhet e lumit Sena e tij. Por ai ishte edhe një militant komunist që i përqafoi idetë e majta në Francën antifashiste e cila ishte ngritur e gjitha në këmbë për të mbrojtur lirinë dhe demokracinë e kërcënuar nga fashizmi italian, ai fankist spanjoll dhe nazizmi gjerman. Në Evropë po frynin e rërat e barutit të luftës dhe po buçisnin oshtimat e artilerisë dhe avionit.

Gjatë qëndrimit në Francë doktor i ri ka qenë për tetë vjet anëtar i Partisë Komuniste Franceze dhe drejtues i komunitetit antifashist

shqiptar. Gjatë qëndrimit në Francë, si njëri prej drejtuesve të atij komuniteti, së bashku me Nako Spirun, Qamil Çelën, Sejfulla Maleshovën, Dhori Samsurin, Gogo dhe Kozma Nushin e shokë të tjerë.

Atje ka organizuar protesta të fuqishme në mbështetje të popullit spanjoll kundër rebelimit fashist të Frankos dhe mbështetjes të vullnetarëve shqiptarë që luftonin në Spanjë si: Mehmet Shehu, Skënder Luarasi, Petro Marko, Mane Nishova, Asim Vokshi, Justina Shkupi që ka punuar spitalet dhe infermieritë me doktor Betynin e famshëm, “Mjekun e tre kontinenteve” e, shumë të tjerë.

Madje pati edhe shumë dëshmorë nga luftëtarët shqiptarë. Ymeri ka pritur e përcjellë vullnetarët shqiptarë për në front. Të parin ndër ta ai ka takuar Petro Markon, e më pas edhe të tjerët. Gjatë ditëve të prillit 1939, kur trupat fashiste italiane pushtuan Shqipërinë, Ymer Dishnica me shokë, emigrantë, punëtorë dhe studentë shqiptarë që bëheshin disa qindra, organizuan manifestime të fuqishme dhe shkruan protesta e pamflete të fuqishme në gazetatat dhe revistat e emigracionit shqiptar dhe atij të huaj si dhe botuan në shtypin antifashist francez.

Duke qenë një nga aktivistët veteranë të Grupit Komunist të Korçës, me kulturë të shëndoshë evropiane –perëndimore, që mbante lidhje të rregullta me Atdheun, kthehet në Korçë si mjek i kualifikuar por,

edhe si antifashist me përvojë, hap klinikën e tij mjekësore private, para se sa të themelohej PKSh-ja. Në këtë klinikë kryheshin më shumë aktivitete politike antifashiste klandestine dhe takime pune partie me anëtarët e grupeve atdhetare, se sa vizita mjekësore.

Kishte filluar Lufta Antifashiste Nacional-Çlirimtare e popullit shqiptar, për jetë a vdekje. Shumë shpejt policia sekrete e pushtuesve ra në gjurmët e aktivitetit politik të doktor Ymerit, kështu ai ishte i detyruar të kalonte në ilegalitet të thellë. Angazhohet në një aktivitet shumë të dendur e të rrezikshëm, si kuadër kryesor në veprimtarinë drejtuese të Qarkut të Korçës dhe në këtë kohë u kooptua si anëtar i Komitetit Qendror të PKSh-së.

Në Konferencën e Parë Antifashiste Nacional-Çlirimtare të Pezës, më 16 shtator 1942, Ymer Dishnica si delegat i PKSh-së, luajti një rol të rëndësishëm organizativ, sidomos në marrëdhëniet e ndërsjellta me personalitetet nacionaliste. Në Pezë ai u zgjodh anëtar i Këshillit të Përgjithshëm ANÇ të Përkohshëm. Ymer Dishnica gjatë kësaj kohe shpalosi fuqishëm të gjithë talentin e kapacitetet e tij intelektuale dhe organizativo-teorike.

Në Konferencën e Parë të Vendetit të PKSh-së (1943) u shqua për zotërimin e aftësive oratorike brilante. Më 4.7.1943 në Labinot të Elbasanit, Dr. Ymeri zgjidhet anëtar i

(Vijon në faqen 13)

DOSSIER



HISTORIA E TRISHTË E DR. YMER DISHNICËS

(Vijon nga faqja 12)

Shtabit të Përgjithshëm të UANÇSh. Në mbledhjen e rëndësishme të Mukjes, e cila i filloi punimet në shtëpinë e Ihsan Toptanit në fushën e Tiranës, ku më vonë u strehua edhe koloneli anglez Nikols, i plagosur rëndë në këmbë, (ku dhe vdiq si rezultat i gangrenës së pashërueshme) dhe më pas i zhvilloi punimet në muajin gusht të vitit 1943 në Mukje.

Ymer Dishnica, kryetar, Mustafa Gjinishi dhe një delegacion i gjerë që përfaqësonte forcat e majta dhe Frontin Nacional-Çlirimtar, kurse 'Ballin Kombëtar' e kryesonte Mit'hat Frashëri dhe një delegacion po aq i gjerë sa ai i Frontit Nacional-Çlirimtar, biseduan gjerëgjatë për problemet e Luftës së përbashkët kundër pushtuesit dhe Shqipërisë etnike, çka binte ndesh me synimet e Miladin Popoviçit dhe Dushan Mugoshës si emisarë të Partisë Komuniste Jugosllave dhe Josif Broz Titos pranë Komitetit Qendror të PKSh-së, që drejtonte Luftën në Shqipëri. Pikërisht për qëndrimin korrekt në këtë mbledhje, u akuzua për oportunitizëm dhe u ndëshkua vetëm doktor Dishnica, ndonëse delegacioni i majtë përbëhej edhe nga disa personalitete me shumë influencë të LANÇ-it, i qëndroi besnik platformës së miratuar me kohë nga Komiteti Qendror i PKSh-së. Në Plenumin e Helmësit (maj, 1944), ku nuk ishin të pranishëm as gjysma e anëtarëve të Komitetit Qendror të Përhershëm të PKSh-së, çka përbën një shkelje të rëndë procedurale të organeve të partisë dhe paramendimin për të akuzuar dhe ndëshkuar vetëm Ymer Dishnicën!

Gjithsesi, LANÇ-i vazhdonte e ky personalitet i mençur dhe i shquar

i saj, vazhdonte të militonte, tejet i angazhuar, në organet e LANÇ-it dhe ai drejtonte sektorët që i ishin ngarkuar dhe së bashku me mikun e tij të zemrës, profesor Sejfulla Maleshova, i jepnin gjallëri dhe hare çdo tubimi apo aktiviteti politik të LANÇ-it, me qëndrimi me tyre gazmor dhe intelektual. Në Kongresin e Parë Antifashist Nacional Çlirimtar të Përmetit (maj 1944), u zgjodh anëtar i Komitetit Antifashist Nacional Çlirimtar për Shëndetësinë, që kishte atributet e një Qeverie të Përkohshme Popullore.

Më 22 tetor 1944, në qytetin e Beratit u emërua ministër i Shëndetësisë i Qeverisë Demokratike të Shqipërisë, e cila hyri në Tiranën e çliruar më 28 nëntor 1944. Paralel me punët dhe aktivitetin e përditshëm që ishte shumë i ngjeshur, sepse në Shqipëri po ngrihej gjithçka nga e para në jetën sociale, së bashku me profesor Sejfulla Maleshovën, doktor Ymer Dishnicën, Dhimitër Shuteriqi, poetin Mark Ndoja, publicistin Shefqet Musarai, shkrimtarin Petro Markon por edhe me At Vinçens Prenushin, Andrea Xegën, Dhimitër Paskon, Nexhat Hakiun, Sterjo Spasen, Vedat Kokonën, Selaudin Toton etj., një pjesë e të cilëve më pas u burgosën dhe u persekutuan, krijuan për herë të parë në Shqipëri, Lidhjen e Shkrimtarëve dhe morën vendim të botohej revista "Bota e Re", "Letërsia jonë" etj.

Kjo bashkësi ishte me prejardhje jo vetëm nga PKSh-ja dhe LANÇ-i dhe nga e majta, sepse deri atëherë ishte treguar një qëndrim sektar, çka ishte e vërtetë. Pikërisht ato ditë, Sejfulla Maleshova së bashku me doktor Ymer Dishnicën, pritën deri në mesnatë, në sallën e Kinema "Kosova", shkrimtarin sovjetik me

famë botërore, Ilia Erenburg, të cilin e shoqëronte dramaturgu frëngjisht folës, Hetem Haxhiademi.

Por kjo shkëndijë demokracie dhe lirie sociale, siç ishte Lidhja e Shkrimtarëve të Shqipërisë, Sindikatat apo Bashkimet Profesionale, Shoqata e Miqësisë Shqipëri-Rusi, e cila fillimisht kishte kryetarë: Zëvendëskryeministrin shqiptar, gjeneral lejtenat Koçi Xoxe, anëtarin e Byrosë Politike Nako Spiru, Hysni Kapo, Tuk Jakova e të tjerë, u mbyt shumë shpejt nga regjimi diktatorial.

Në vitin 1947, Ymer Dishnica, për shkaqe thjesht politike, shkarkohet nga detyra e ministrit të Shëndetësisë dhe lihet në dispozicion të ministrisë së Punëve të Jashtme, në një punë të dorës së fundit, ky intelektual dhe antifashist brilant. Me dëshirën e tij, doktori heq dorë përfundimisht nga politika, veshi bluzën e bardhë të mjekut patolog dhe filloi punën në spitalin e Tiranës (1948) dhe punonte si pedagog në shkollën e mesme mjekësore.

Më 2 janar 1950, me vendim të posaçëm dëbohet familjarisht nga Tirana për në Berat, ku punoi si drejtor i Drejtorisë të Shërbimit Shëndetësor, në spital dhe në ambulancën e qytetit. Në qershor të vitit 1955, për ironi të fatit, me porosi të vetë kreut të piramidës partiake, (Enver Hoxha), arrestohet dhe dënohet me gjashtë vjet heqje lirie, me akuzën "për agitacion e propagandë kundër shtetit"!!! Pas një viti, me ndërhyrjen e njeriut që ndihmoi shumë financiarisht për krijimin e PKSh-së, xhaxhait të tij, Esat Dishnica, i falet dënimi i mbetur (!), por kjo "falje", u shoqërua me një tjetër vendim çnjerëzor të Komisionit të Dëbim-Internimeve.

Ky organizëm vrastar stalinis-

to-enverist e internon doktor Dishnicën në qytetin e Beratit, për një afat pesë vjeçar. Ymer Dishnica, ndonëse i internuar, pra i persekutuar politik, ishte njeriu më i vlerësuar, më i respektuar nga populli i thjeshtë i qytetit dhe pacientët e tij të shumtë. Gjithsesi, ai mbeti familjarisht atje ku ishte, i izoluar dhe i mbikëqyruar ashpër nga organet e Sigurimit të Shtetit, deri në kohën e përmbysjes të diktaturës së Enver Hoxhës dhe klikës së tij.

Doktor Dishnica, ndër kohë ishte shumë i kujdesshëm, studionte dhe lexonte literature profesionale të përparuar të kohës, por edhe i ndiqte me vëmendje e kujdes situatat politike të kontinentit. Ai, gjithsesi e ndjente shpresën e madhe të demokracisë dhe liria politike dhe sociale, e cila me gjithsesi me shumë vonesë, po vinte më së fundi edhe në Shqipëri. Personaliteti i madh shqiptar Ymer Dishnica, mundi më së fundi të kthehet i lirë në Tiranë, në vitin 1995, i lodhur por optimist. I përndjekur, por i pa përkulur nga shtypja e gjatë.

Në vitin 1994, me gjithë moshën jo të re, zgjidhet kryetar i Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare të Popullit Shqiptar.

I pa pajtuar me diktatorin. Pse? Sepse me Enver Hoxhën, divergjencat e doktor Dishnicës, kishin filluar shumë herët dhe ishin të papajtueshme, diktatori njerëzit si personalitetet e tipit të Ymer Dishnicës, me një integritet dhe pavarësi mendimi shembullore, nuk mund t'i duronte si bashkëpunëtorë, ndaj edhe i eliminoi apo i sakatoi fizikisht, një nga një, por nuk mundi kurrë t'i mposhtë moralisht, as atëherë kur i burgosi për një kohë të gjatë apo, i eliminoi fizikisht.

Doktor Dishnica si rezultat i aktivitetit të tij të jashtëzakonshëm antifashist dhe luftarak, ka qenë i zgjedhur deputet i Kuvendit Popullor, që në legjislaturën e parë dhe i nderuar me shumë dekorata urdhra dhe medalje të RPSH-së dhe të vendeve të tjera aleate. I nderuari Dr. Ymer Dishnica, vdiq në gjirin e familjes, i qetë dhe i respektuar nga familjarët, të afërmit, miqtë, shokët, veteranët dhe luftëtarët e LANÇ-it, më 22.9.1998.

Shoqëria shqiptare humbi kështu një njeri emblemantik, të edukuar, të shkolluar, të përkushtuar dhe të kultuar në shkallën më sipërore, që do të kujtohet për një kohë shumë të gjatë dhe do të zërë vendin e merituar në panteonin e nderit të kombit shqiptar.

Autori i këtij studimi biografik, është prej pionierëve veteranë më të vegjël të LANÇ-it si dhe prindër e tij, kanë pasur rastin e lumtur ta njohin nga shumë afër këtë personalitet të shquar e të veçantë të LANÇ-it, si dhe e kanë pasur mik familjar të nderuar që kur u kthye nga studimet universitare nga Franca dhe koleg të prindërve të tij, të cilët gjithashtu kanë qenë luftëtarë antifashistë të orëve të para, që nga koha e para pushtimit fashist e, deri në momentin që doktor Ymer Dishnica u nda nga jeta.

/ *Memorie.al/ Nga Prof. As. Dr. Gjergj P. TITANI*

REFLEKSIONE

Identiteti i popullit tonë ka qënë i lidhur ngushtë me gjuhën, kulturën dhe traditat e përbashkëta.

Motivimi i traditave dhe vlerave kombëtare nga dasmat kosovare e shqiptare



Nga Nuri Bufi

Burimet mbi shprehjet e vlerave patriotike, kombëtare tek shqiptarët zënë fill në periudha të lashta. Shqipëria është një tokë me histori mijëvjeçare, që ka njohur si pushtimet ashtu dhe luftërat për pavarësi. Po ashtu ka dhe një trashëgimi jashtëzakonisht të pasur kulturore dhe atdhetare. Armiqësit dhe synimet grabitqare të fqinjëve të huaj bënë të domosdoshme forcimin e unitetit, vlerave dhe traditave të kombësisë shqiptare. Emri i Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu si simbol i rezistencës shqiptare kundër Perandorisë Osmane është pjesë e ndërgjegjes historike dhe kulturore e çdo shqiptari. Njohja e kësaj figure dhe kontributit në histori, nuk është vetëm një akt kujtese, por një mënyrë për të forcuar ndjenjën e përkatësisë dhe krenarisë së identitetit.

Populli ynë në luftën për ekzistencë, për të ruajtur e afirmuar individualitetin e vet, ka pasur jo vetëm aspirata të ndërgjegjshme të kombësisë por dhe filozofinë e tij të qasjes etike dhe asaj etnike. Janë evidente veçoritë dalluese të kombit shqiptar nga kombësit e tjera, si karakteri popullor e kombëtar i përbashkët, i shprehur me përshkrimin e zakoneve e të dokeve, të ngjyrave e veçorive lokale, të evokimit e përfitimit të atmosferës së lashtësisë, të paraqitjes së ambienteve patriarkale të malësisë, të elementëve folklorik dhe etnografike.

Të qënë shqiptar nuk është vetëm një çështje e lindjes por edhe e kulturës, vlerave dhe traditave që duhen ruajtur dhe transmentuar. Në vazhdim, generatat nuk duhet kurrë të zbehin identitetin, si një pasurim në rikujtimin dhe rrëfimin e Shqipërisë, historisë dhe letërsisë së saj.

Është një akt dashurie ndaj rrënjëve tona dhe një dhuratë për brezat e ardhshëm.

Ka një rrëfim shqiptar unik e atraktiv për Kosovën, që prezantohet me anën e miteve kulturore kombëtare. Referuar historisë Kosova mbetet epiqendra e përplasjeve të perandorive dhe si vatra vullkanike e kombformimit shqiptar. Ne kemi nevojë për rrëfenjat drithëruese e motivuese, mbi frymën mitike shqiptare e cila nuk duhet t'na mungojë. Nëpërmjet trashëgimisë kulturore dhe historike që lidh shqiptarët nga të gjitha trojet do

mund të sigurohet një të ardhme e qëndrueshme dhe e harmonishme për gjithë shqiptarët.

Identiteti i popullit tonë ka qënë i lidhur ngushtë me gjuhën, kulturën dhe traditat e përbashkëta. Kjo lidhje e ngushtë ka ndihmuar në ruajtjen e një kujtese të përbashkët deri në ditët tona. Marrëdhëniet e vazhdueshme kulturore mes trevave shqiptare, si dhe ato në fushën e turizmit kanë ofruar më shumë qëndrueshmëri dhe rituale të përbashkëta të traditave popullore. Fryma e herëshme shqiptare e popullore e cilësuar si "Bota e këngës popullore" shfaqet nëpërmjet larmisë së formave, krahinore e gjithëpërfshirëse kombëtare, të koloritit të gjuhës e të ambjenteve, gjithnjë në përputhje me psikologjinë dhe njëmëndësinë e popullit.

Me ndryshimin e etapave historike të shoqërisë dhe kombit shqiptar, përparësi mori dhe arti me gjithë elementët folklorik, të cilat janë futur si pasuri e trashëgimisë kulturore në fondin e artë të këngës popullore kombëtare. Ky art i ngjnjëzuar në tabanin popullor sot veç tubimit nëpërmjet skenave e programeve të shumta të radio-televizionit, me më shumë forcë e gjallëri si produkt shoqëror mes traditave ndër breza i ka shërbyer organizimeve festive, fisnore, kryesisht të dasmave me kurorëzimin e çifteve të reja familjare.

Veçanërisht në dasmat kosovare shquhen mjaftë elementë të traditave të hershme shqiptare. Bbashkë me këngët dhe vallet, shquhen fort dhe motivet kombëtare. Mes shumë festimeve dhe or-

ganizimeve të dasmave veçojmë atë të organizuar kohët e fundit në Prishtinë. Nga familjarët Latif dhe Fatmira Sinani me martesën dhe kurorëzimin e djalit Durim Sinani me zonjushën Kaltrina Qamili, nga ku marrim emocione mbresëlënëse. Krahas pranisë së qindra pjesëmarrësve të ftuar, shquhen dekorimet masive, ku sundon ngjyra e kuqe e flamujve kuqezi, pranin e të cilëve e përjetojmë bashkë me ceremonin martesore dhe si një festë e vërtetë kombëtare. Kjo ceremoni martesore kalon përmes shfaqjes të disa ritualeve me origjinë të herëshme të traditave popullore të ruajtura ndër breza, si: Bluarja e drithërave mes dy gurëve, me rrotullimin me dorë të gurit të sipërm. Nëpërmjet një doreze bereqeti hidhej në hapësirën e qëndrës së gurit të sipërm.

Po ashtu, ndezja e zjarrit pranë vatrës, riti i Kanagjegjit me shtruarjen e sofrës, ku sitej mielli për zëniën e brumit. Iyerja e pragut të hyrjes së shtëpisë me mjalt e tji. Të gjitha këto rituale përshkoheshin me praninë e flamurit kuqezi shqiptar.

Nga kjo festë familjare të quajtura "Dasma" vërtëton më së miri përmbajtjen e kësaj fjale, që do të thotë njëherësh demonstrim dhe motivim i vlerave, i bashkimit si komb. Ky demonstrim vlerash shkon paralel jo vetëm me urimin e çiftit për një jetë të lumtur, por njëkohësisht me betimin për të qënë një familje e re dhe një forcë e re në mbështetjen dhe ruajtjen e traditave kulturore kombëtare.

Këtë demonstrim vlerash nëpërmjet ceremonive martesore e shohim edhe në zona të tjera të Kosovës si në zonën e Prizrenit,

informojnë etiologët Dervish Sejfiq, Vehbi Hoxha, vëllezërit Hamdi e Nazim Hoti dhe profesor Ali Berisha.

Edhe në Shqipëri, pas '90-tës, në festat familjare nisën motivimet dhe demonstrimet për shquarjen e lëvrimin e traditave të herëshme popullore dhe të identitetit Shqiptar. Këto u demonstruan edhe në festën martesore (Dasmën), organizuar në qytetin e Fierit pranë lokalit "Gold - Graund" nga familjarët (bashkëshortët) Dashnor (Barjami) dhe Lida Bufi, me martesën e djalit Fjorarbro Bufi me zonjushen Trendafilë Sina. Grupi i valleve të portokallisë, vajza dhe djem, me veshjet e kostumet kombëtare, njëkohësisht këtë uniform ofruar dhe çiftit, debutuan magjinë finale, simbolikë kombëtare.

Me një shpejtësi të rrufeshme ata mbuluan gjithë hapësirën e vallëzimit me flamurin shqiptar të zmadhuar, ku në qëndër një hapsirë e improvizuar në kryet e shqiponjës, shquan çiftin e përfaqëuar. E gjithë salla në këmbë, mes duatrokitjeve e brohoritjeve dhe mes valëvitjeve të flamurit kuqezi. Kësisoj, festat familjare, krahas mjeteve gjithë përfshirëse të propagandës kulturore - popullore, mbeten një trashëgimi e fuqishme, kulturore dhe historike që do të lidh shqiptarët nga të gjitha trojet. Identiteti shqiptar ka qënë gjithmonë i lidhur ngushtë me historinë dhe kulturën e kombit. Kjo lidhje e ngushtë ka ndihmuar në ruajtjen e një kujtese të përbashkët që mbart një narrativë të qëndrueshme të luftës për liri, pavarësi dhe të drejtat kombëtare.



REFLEKSIONE

Brezi që dhuroi jetën për lirinë e Shqipërisë na la një amanet: Atdheu është përgjegjësi

DËSHMORËT MBETEN TË RINJ NË SHEKUJ

**Prof.asoc.dr. Bernard ZOTAJ –
Mjeshtër i Madh**

Historia e Shqipërisë është endur me fije gjaku e fljimi, e veçanërisht në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare u shënuan faqe të lavdishme që nuk i zbeh asnjë kohë. Çdo krahinë, çdo fshat e çdo familje dha pjesën e vet në përpjekjen titanike për liri. Mes shumë emrave që ndriçojnë kujtesën kombëtare, qëndrojnë edhe tre dëshmorë të rinj: Zeqir Hetem Deromemaj, Gani Bajram Gabaj dhe Sejdi Ormën Muraj, të cilët e shkruan me jetën e tyre një testament të pavdekshëm atdhetarie. Ata nuk jetuan gjatë, por jetuan me qëllim të madh: lirinë e Shqipërisë. Prandaj mbeten të rinj në përrjetësi.

ZEQIR DEROMEMAJ – JETIMI QË RA DËSHMOR NË KUKËS

Historia e Zeqir Deromemajt është histori e dhimbshme, por madhështore. I lindur në Mesaplik në vitin 1923, ai u rrit jetim, pasi i ati u vra që herët. E ëma, nëna Pashakoja, e rriti mes varfërisë por me dinjitet e karakter të pathyeshëm. Ajo i dha të birit edukatë, dashuri për librin dhe ndjenja të pastra atdhetare. Zeqiri u dallua në shkollë për zgjuarsin e kulturë, por në kohë pushtimi, libri u ndërpre nga detyrimet e luftës.

I përfshirë në lëvizjen antifashiste, ai u përjashtua nga shkolla Tregtare e Vlorës, u arrestua, u burgos e më pas u lirua për mungesë provash. Në gusht 1943 u rreshtua në çetën partizane “Zigur Lelo” dhe më vonë në Brigadën e V Sulmuese. Edhe pse i ri, ai mori funksione drejtuese dhe në vitin 1944 u caktua zëvendëskomisar kompanie. Ra heroikisht në Kukës më 3 tetor 1944, vetëm pak ditë para çlirimit.

Nëna Pashako i ruajti si relike dy letrat e tij të fundit, ku Zeqiri shkruante:



“Kush vdes si burrë në ballë të luftës, emri i tij do të mbetet i paharruar në histori e këngë...”. Dhe vërtet, emri i tij sot mban shkolla 9-vjeçare e Mesaplikut, ndërsa ai është dekoruar me medaljet “Trimëria” dhe “Kujtimi” dhe është shpallur Dëshmor i Atdheut.

GANI BAJRAM GABAJ – TRIMI I RAMICËS QË RA NË GJAKOVË

Nga Ramica e Smokthinës vjen një tjetër figurë e pavdekshme: Gani Gabaj, lindur më 1921 në një familje atdhetare. Familja Gabaj dha shumë për luftën: djep trimash, strehë për partizanë, vatër sakrifice.

Ganiu dezertoi nga ushtria fashiste

në vitin 1942 dhe u bashkua me çetën “Plakë” të Vlorës. Mori pjesë në betejat e Gjormit, Selenicës dhe Drashovicës. Më pas u rreshtua në Brigadën e V Sulmuese dhe bashkë me të marsoi deri në Kosovë.

Në betejën për çlirimin e Gjakovës më 16 tetor 1944, Ganiu u shqua për trimëri të jashtëzakonshme. Në një moment kritik, kur armiku kishte marrë një pozicion të fortifikuar, ai u hodh me granata për të hapur rrugën e fitores. Edhe pse i plagosur, vazhdoi luftimin derisa ra heroikisht. Populli gjakovar u ngrit atë ditë për të ndihmuar partizanët shqiptarë – një vëllazëri gjaku që nuk harrohet.

Ganiu prehet sot në Varrezat e

Dëshmorëve në Vlorë dhe është nderuar me medalje dhe mirënjohje. Familja e tij është simbol krenarie për Smokthinën.

SEJDI ORMËN MURAJ – KOMISARI QË MBETI FLAMUR NË JUNIK

Një tjetër bir smokthinjot, Sejdi Muraj, lindi në Bashaj më 1920. Edhe ai u rrit në frymën e patriotizmit. U arratis nga ushtria fashiste në vitin 1942 dhe u bashkua me çetat partizane. U burgos nga pushtuesit, por u lirua pas një aksioni të njësitit gueril në Vlorë. Ai u dallua për karakter, përkushtim dhe integritet. U ngjit në detyra drejtuese dhe u emërua komisar kompanie në Brigadën e V Sulmuese.

Ra heroikisht më 25 tetor 1944 në Junik të Gjakovës, duke udhëhequr shokët në luftë të drejtpërdrejtë me gjermanët. Lajmi i rënies së tij mbërriti në shtëpinë e nënës Metullaha, e cila e priti me dinjitet e shtërngoi lotët duke thënë: “Mendoni sa nder na sollën bijtë tanë, ndaj përpiquni të jeni të denjë...”

Familja Muraj ka tre dëshmorë dhe kujtimi i tyre nderohet në rrugë e shkolla të Vlorës. Sejdi u shpall po ashtu Dëshmor i Atdheut.

PËRFUNDIM: DËSHMORËT MBETEN TË RINJ PËRGJITHMONË

Brezi që dhuroi jetën për lirinë e Shqipërisë na la një amanet: Atdheu është përgjegjësi. Zeqiri, Ganiu dhe Sejdi nuk jetuan gjatë, por jetuan me dinjitet. Ata mbeten të rinj në këngë, në histori, në kujtesë. Jeta e tyre u ndërpre, por lavdia e tyre nuk shuhet. Ata ishin bij të popullit - djem nënash, që u rritën ndër male, mbajtën pushkën dhe besuan te liria. Për ta, atdheu ishte fjala më e shtrenjtë.

REAGIMI

Turistët rrugaçë fyejnë Faik Konicën dhe Frashëllinjtë

SEFER PASHA

Befasisht mbi tridhjetë turist që të gjithë të rinj i përplasën biçikletat në sheshin përpara monumenteve të Faik Konicës, të tre vëllazërve Frashëri dhe të Mitat Frashërit në Parkun Kombëtar të Tiranës.

Qytetarët që pushonin nëpër stola e morën vesh se ata ishin turist. Ra në sy sjellja e tyre prej horrash. Ata qeshnin njëri më tjetrit dhe lëshonin pordhë në sy të publikut. Sikur të mos mjaftonte kjo filluan të urinojnë mbi varret e korifejve të kombit. Njëri nga rrugaçët u ul pas monumentit të Konicës dhe e qelbi fare. Nja dy veteranë filluan ta qëllonin me gur. U telefonua dhe policia. Por çështja nuk është kaq e thjeshtë. Në Shqipëri fërkojnë duart nga gëzimi kur rritet numri i turistëve

që hyjnë në Shqipëri. Doemos që është një gjë pozitive. Por sot për sot del një problem i cili nuk ishte menduar. Shumë turist të cilët hyjnë në Shqipëri nuk kthehen më andej nga kanë ardhur. Ka prej tyre që punësohen. Më thonë se ka dhe ndonjë lindje ilegale që nuk rregjistrohet në asnjë gjendje civile. Në ullishtat e Vlorës që një çift sirjanësh. Kur erdhën ishin dy dhe tani janë bërë katër. “Mëhalla” po shtohet. Banesa të braktisura ka me dhjetra në ullishta, anës Shushicës dhe përpjetë në Lumin e Vlorës. Midis nesh po lindin fshatra të reja të njerëzve me ngjyrë. Zezakët do ta këndojnë këngën:- /Sazan e Karaburun//Janë vatanet e mia/. Kjo është njëra anë. Por midis këtyre kontigjenteve ka që meren me drogë, prostitucion e trazohen në botën e krimit. Me kodet e tyre i bien prostitutat që nga Brazili. Lind

pyetja: - Kush i kontollon këto monstra siç është dhe rrugaçi që mënderosi varrin e Faik Konicës. Lulëzimi i këtyre maskarenjëve po kthehet në dramë.

Situata më duket e rëndë. Ajo që ndodhi mbi varret e simboleve të kombit të bën që t’i vësh duart në kokë. Na rroftë numri i turistëve që po rritet dhe harxhojnë ndonjë lekë për të blerë byrek e qofte. Atë që pashë sot nuk kam kujt t’ja tregojë. Në lagjen time në kafën “Las Vegas” çdo mëngjes e pinim kafën me poetin Petrit Ruka. Po të ishte gjallë do t’ja rrëfeja atë që më panë sytë. Këtë dhe xhevaire më të pista. Po Petrit Ruka u ngjit shpejt në bronx dhe unë ndjej dhimbje që nuk u ndodha në Tepelenë “ditën e lotëve”. Në kafenenë tonë të preferuar Petrit Ruka më ka lexuar për herë të parë poezinë e tij makbethjane: - “Shqipëria u shit. Ankandi u mbyll”.

PROMOVIMI

Dhjetra personalitete akademike e të letrave dhe drejtues të OBVLP vlerësojnë librin monografik “PO KTHEHEM NË HOTESH”

SKËNDER MURRJA - mësuesi, që u dashurua me profesionin e tij të bukur

• **FESTIME MJESHTRI - KRYETARE E BASHKISË BULQIZË:** Ky botim është pasqyrë e jetës së një mësuesi të përkushtuar që nuk u nda asnjë ditë nga shkolla duke dhënë mësim dhe duke drejtuar me përgjegjësi institucionet arsimore të Matit e Dibrës...

• **TATJANAPARLLAKU ÇARKAXHIU:** “OBVLP krenohet me Skënderin, i cili punon me përkushtim për të mbajtur gjallë kujtimin, veprën dhe idealet e atyre që dhanë jetën për lirinë e atdheut. Ai dhe shumë pasardhës të tjerë të veteranëve, me shembullin e tyre, frymëzojnë brezat e rinj të rriten me dashurinë për vendin, për paqen dhe për njeriun”....

Libri i autorit Skënder Murrja “PO KTHEHEM NË HOTESH” që u promovua më 12 tetor 2025 në Akademinë e Shkencave në Tiranë, me praninë e qindra pjesëmarrësve nga vendlindja e autorit dhe nga miq e shokë të shumtë të tij me banim në Tiranë, Peshkopi e Durrës, u vlerësua për mesazhet që përcjell mësuesi veteran me kontribut të pandërprerë në edukimin mijëra nxënësve në disa shkolla të Qarkut të Dibrës.

Fillimisht u ndoq me interes të veçantë dokumentari (I përgatitur nga unë H.R) që pasqyrore me mjeshtri e art shembullin e një mësuesi që me pasionin për dije dhe dashurinë për nxënësit punoi një jetë tërë. Ishin këto dije të thella e të qëndrueshme që ai i mishëroi dhe përçoi me përkushtim e dashuri, të cilat do t’u shërbenin qindra e mijëra nxënësve të tij, nga Derjani i Matit, Luznia, Muhurri, Çidhna, Katër Grykët e Bulqiza, si arma më e fuqishme për jetën.

Dyzetëdy vite kontribut pa ndërprerje, si mësues dhe drejtor i disa shkollave në tre rrethet e Qarkut Dibër, të finalizuara në këtë libër, u vlerësuan maksimalisht dhe nga kryetarja e Bashkisë Bulqizë, Znj. Festime Mjeshtri. Ajo e vlerësoi këtë botim si pasqyrë të jetës së një mësuesi të përkushtuar, që nuk u nda asnjë ditë nga shkolla duke dhënë mësim dhe duke drejtuar me përgjegjësi institucionet arsimore të Matit e Dibrës.

Luljeta Prenci, Drejtore e Gjimnazit “Ibrahim Rugova” Kamëz, e vlerësoi librin “Po kthehem në Hotesh” një prozë memorialistike që për nga zhanri, është një autobiografi e ndërthurur me kujtime dhe pasazhe të tjera që i kalojnë kufijtë e një autobiografie të mirëfilltë. Kjo sipas saj për faktin se në këtë libër është një jetë, bilanci i së cilës e bën krenar këdo; një jetë përkushtuese dhe që afirmon personalitetin e individit përmes punës.

Kryetarja e Org. Bashkuar të Veteranëve të LANÇ e Pasardhësve, Znj. Tatjana Parllaku – Çarkaxhiu, ndër të tjera në fjalën e saj tha se OBVLP krenohet me Skënderin, i cili punon me përkushtim për të mbajtur gjallë kujtimin, veprën dhe idealet e atyre që dhanë jetën për lirinë e atdheut. Pikërisht për këtë kontribut madhor ajo dhe Nënkryetari i kësaj organizate Z. Muharrem Gjoka – Mjeshtri i Madh, i akorduan mësuesit veteran Skënder Murrja “CERTIFIKATË



MIRËNJOHJE”. Demir Osmani që ka pasur fatin të jenë së bashku me Skënder Murren, nxënës në gjimnaz, në Institut, mësues në Mat e Dibër, ndër të tjera evidentoj faktin që “Skënderi i dha arsimit në Dibër rininë, pjekurinë, burrinë dhe i mori mirënjohjen, dashurinë dhe respektin e shumë brezave”.

Në të njëjtën linjë e vlerësoi mësuesin veteran Skënder Murrja edhe bashkënxënësi e bashkëstudenti i tij në gjimnazin e Durrësit e në Institutin Pëdagogjik të Shkodrës, Bashkim Lami, i cili në cilësinë e kryetarit të Shoqatës Atdhetare “BULQIZA” i dha atij “CERTIFIKATË MIRËNJOHJE”.

Faik Xhani, ndër të tjera e vlerësoi Skënder Murren si veprimtar shoqëror për kohën që ishte sekretar i Komitetit të Rinisë Luzni e në ushtri,

anëtar i Plenumit të Rinisë Dibër dhe kryetar i Sindikatës së Arsimit Bulqizë.

Prof. dr. Arif Murrja – pedagog në Universitetin Bujqësor Kamëz u ndal te një aspekt i veçantë: vendlindja në librin e Skënder Murrës.....Sepse, me këtë libër ai na kujton se vendlindja nuk shuhet kurrë nga zemra e njeriut. Ajo mbetet udhërrëfuese shpirtërore që na udhëheq në çdo hap të jetës. “Libri ‘Po kthehem në Hotesh’- monografi, është një udhëtim i shpirtit drejt vendlindjes. Që në hyrje autori na ndal te emri i Hoteshit dhe etimologjia e tij. Ai na kujton se vendlindja nuk është thjeshtë hapësirë gjeografike, por një trashëgimi kulturore dhe shpirtërore, që duhet ruajtur me kujdes”, -tha ndër të tjera Prof. dr. Arif Murrja.

Më të larmishëm e bëri këtë event edhe këngëtarja e talentuar Vera Laçi me interpretimin virtuoz të disa këngëve popullore dibrane, për të cilat u duartrokoi fuqishëm nga pjesëmarrësit.

Figurën e mësuesit Skënder Murrja e lartësojnë shumë cilësi, por ato që shfaqen më dukshëm, janë sinqeriteti dhe bujaria, mikpritja dhe dashuria që ushqen për të gjithë njerëzit.


Skënder Murrja është dhe një veprimtar i palodhur shoqëror. Ai, bashkë me shumë shokë të vjetër mësues të Dibrës dhe jo vetëm, edhe si anëtar i kryesisë së OBVLP, bën një punë të mirë atdhetare për njohjen dhe vlerësimin e Luftës e të heroizmit shqiptar në shekuj për çlirimin dhe mbrojtjen e vendit nga pushtuesit.

SUPLEMENTI LETRAT

Libri i 30-të - Promovimi me 28 Tetor 2025, ora 11.00 në Kinema "Maks Velo", Laprakë

HALIL RAMA - Mjeshtër i Madh në publicistikë, por jo vetëm...

- Kredoja e poetit del te poezia "Të rënëve": "Në zemrat tona njëmijë herë jeni rritur, /Ju o pishtarë të lirisë /S'do harroheni në njëmijë breza, /Vepra juaj në pedestal është ngritur."
Në poezitë kushtuar vendlindjes në krye të vendit qëndron ajo për origjinën e Kastriotëve. Kujtojmë se autori e ka origjinën nga këto troje.



Në 65-vjetorin e ditëlindjes time, një tufë me poezi e tregime dedikuar familjes, miqve e shokëve të shumtë në hapësirën mbarëshqiptare në botë...

1. ODA DIBRANE

Oda dibrane: Besa e burrit, Qëndresa e trimit, Përkrahja e mikut, Çerdhe e patriotizmit.

Oda dibrane: Grumbullim njerëzish Dashuria midis tyre Këshilla e prindit Vatër mikpritje...

Oda dibrane: Mençuria e fjalës, Urtësia e të moshuarve Fundi i armiqësive Kënaqësia e muhabetit.

Oda dibrane: Burim i humorit Shpërthimi i këngës Sheshi i kërcimit.. Jehona e të qeshurit...

Oda dibrane: Zanafilla e ngjarjeve Kuadrati i lodrave Tempull për pleqtë, Shkollë për të rinjtë.

Oda dibrane: Dhe në Filadelfia Mbledh "Bijtë e shqipës" E ndërtoi Haki Çollaku "Qytetar Nderi" i Dibrës.

Oda dibrane: Në festivale, Çdo vit bashkë Me këngë e me valle Shqipëri e Madhe...

HALIL RAMA

Nga Sakip Cami Poet, publicist, studios

"Në 65-vjetorin e ditëlindjes time, një tufë me poezi e tregime dedikuar familjes, miqve e shokëve të shumtë në hapësirën mbarëshqiptare në botë".

Ky është dedikimi i poetit dhe shkrimtarit Halil Rama në faqen e parë të librit të tij të 30-të "ODA DIBRANE".

Këtë 28 tetor, miku im i kahershëm i letrave dhe i familjes Halil Rama është 65 vjeç dhe ky libër më hodhi në vitet e hershme të krijimtarisë sime dhe të Halilit.

Ishte vetëm 20 vjeç kur fitoi çmimin e parë në poezi në një konkurs letrar të Rrethit Dibrë organizuar nga Dega e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve me kryetar Artistin e Merituar Hazis Ndreu. Këtë e vërteton edhe një poezi e autorit Rama botuar në gazetën "Ushtima e Maleve" në vitin 1988, që autori pasi e ka gjetur në arkivin e tij e ka futur në këtë libër. "Tek kroi mes livadhit do të të dal unë; /Të të tregoj gurët që kam parë n'këto male"... ("Ushtima e Maleve", - nëntor 1988.)

Por ndërkohë ishte përfshirë në publicistikë me reportazhe, përshkrime, portrete e kronika në shumë gazeta të vendit.

Kush ka punuar në shtypin e përditshëm e di mirë ngarkesën e gazetës së përditshme. Ishte kjo ndoshta arsyeja që Halili bëri një shkëputje të gjatë në kohë nga dashuria e tij e vjetër, poezia.

Dimensioni njerëzor, dashuria për familjen, prindërit, bashkëshorten, fëmijët mbesat dhe nipin zënë vend kryesor në këtë libër.

Ja si shkruan për nënën e tij që i mungon shumë: "Për këdo, e shtrenjtë është nëna/ Por e imja, më e mira, / Ndonëse ish më e përvuajtura/ Ajo që vetë mirësia.....",/

Por unë do të veçoja poezinë kushtuar bashkëshortes që i ka të gjitha brenda saj: "Ndërsa ti dremnit në gjumin e drekës, /Unë lodroj në sytë e tu të shkruar, /Pres të më japësh puthjen e radhës, /Përfjetësisht - Ne të dashuruar."

Në poezitë kushtuar miqve të tij shkrimtarë e intelektualë bie në sy poezia kushtuar Artistes së Popullit Margarita Xhepa dhe ato për shkrimtarët Shefki

Karadaku, Teodor Laço e Hazis Ndreu.

Për Nderin e Kombit Hazis Ndreu, atë që na nxiti dhe inkurajoi në rrugën e letërsisë dhe publicistikës autori shkruan: "Ezopi i Dibrës", Hazis Ndreu/ Odën Dibrane na e la testament /Ai që shpërtheu si Prometeu /Në panteonin e vlerave, ka zënë vend..."

Për të paharruarin Sokol Olldashi, politikan dhe publicist i shquar, bashkëpunëtorë të gazeta "Albania" shkruan: "Ti më mësove si shkruhet lajmi/ Kur bashkë punonim te "Albania"/ Por s'e besoja o Kol vëllai, /Se Brenda teje jetonte poezia..."

Tek cikli "Motive popullore" do të veçonim poezinë "Lule Zoje majë Runjës": "Lule Zoje/ E bardh si bora/ Kush të prek/ I dridhet dora/ Lule Zoje/ Mbetrëshë e malit/ Si ja vodhe zemrën djalit..."

Kredoja e poetit del te poezia "Të rënëve": "Në zemrat tona njëmijë herë jeni rritur, /Ju o pishtarë të lirisë /S'do harroheni në njëmijë breza, /Vepra juaj në pedestal është ngritur."

Në poezitë kushtuar vendlindjes në krye të vendit qëndron ajo për origjinën e Kastriotëve. Kujtojmë se autori e ka origjinën nga këto troje.

"Këtu ka trojet Gjon Kastrioti, /Këtu ka hedhur rrënjë liria./ Muhurri im bukuri nga Zoti, /Mbi të ulur historia."

Poezinë filozofike dhe historike: "I urti dhe I mençuri Sulë Dika" do ta kishte dëshirë ta kishte çdo poet në arsenalin e tij:

"Një mushkë ngarkuar me flori,/Pas saj një misionar anglez/ Sulë Dika, shoqëruesi i tij /Burri që e kishte marrë në besë./ S'mund të pranoj "mall haram" /Kur vendi im rënkon në robëri, /Kështu i tha mendjeholli dibran/ Anglezit që desh ta blinte me flori. /Ka mjegull të madhe në anët tona /S'dihet ku të zë e të merr lufta /Këtu ka sy e vesh edhe toka/ I tha anglezit Sulë Dika" Dhe për ta plotësuar mençurinë e këtij plaku të urtë dibran autori vazhdon: "Në mexhelise i zinte fjala/ Kur e pyesnin: Ç'thotë politika?! /"Burrin e prishin tre gjana: /Parja e madhe, karrikja e naltë dhe gratë e bukura! / Përgjigjeje i mençuri Sulë Dika."

Edhe në pesë tregimet e kapitullit të dytë të këtij libri, secili më mbresëlënës se tjetri të bien në sy gjetjet dhe subjektet në dy kohë.. Veçanërisht dy tregimet e para: "Dashuri të stuhishme në plazhin

e gjeneralit" dhe "Zonja me tri shtetësi e tri shtëpi" sjellin tek lexuesi mesazhe originalë dhe bashkëkohore.

Por tregime të tjera ka në sirtarin e tij të punës dhe të mendjes autori Halil Rama dhe atëhere do t'i analizojmë më në thellësi ato.

FOTOREPORTAZH

OBVLP DHE BOTIMET "UNIVERS" PROMOVOJNË LIBRIN "PO KTHEHEM NË HOTESH"

SKËNDER MURRJA PASUES I NJË FAMILJE ME KONTRIBUTE NË HISTORINË E KOMBIT TONË

TATJANA PARLLAKU ÇARKAXHIU
KRYETARE E OBVLP*

Përkujtojmë sot me nderim të thellë ata që luftuan me zjarrin e rinisë kundër pushtuesve fashistë e nazistë, ata që dhanë gjithçka për lirinë e atdheut dhe që, edhe pse po shuhen dita-ditës, ne i mbrojmë e i ruajmë si thesare të çmuara të kombit tonë, duke u kujdesur për jetën dhe veprën e tyre.

Është pikërisht Skënder Murrja ai që me përkushtim të madh e vazhdon këtë mision fisnik. Ai është pasues i një familjeje të nderuar e të çmuar, që ka dhënë kontribute të mëdha në historinë e kombit tonë. Një nga pinjollët e kësaj familjeje, Arif Markja, ra dëshmor në vitin 1944 në Junik të Gjakovës, duke dhënë jetën në luftë kundër bishës naziste. Sot, eshtrat e tij prehen me nder në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit, këtu në Tiranë.

Prandaj ne krenohemi me Skënderin, i cili sot punon me përkushtim për të mbajtur gjallë kujtimin, veprën dhe ideat e atyre që dhanë jetën për lirinë e atdheut. Ai dhe shumë pasardhës të tjerë të veteranëve, me shembullin e tyre, frymëzojnë brezat e rinj të rriten me dashurinë për vendin, për paqen dhe për njeriun.

Në këtë ditë të përvitshme të librit kushtuar jetës dhe veprës së Skënder Murrës, ne shprehim krenarinë tonë që ai është pjesë e Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. E falënderojmë për kontributin, përkushtimin dhe ndihmën e tij të çmuar në mbarëvajtjen e punëve të organizatës, në shërbim të veteranëve dhe pasardhësve të tyre — atyre që sakrifkuan gjithçka për lirinë dhe për ditët e lumtura që ne gëzojmë sot.

Ne gjithashtu e vlerësojmë me mirënjohje të thellë Skënderin si krenari e organizatës sonë. Me këtë rast, falënderojmë Skënderin dhe mbarë familjen Murrja për këtë veprimtari të rëndësishme dhe premtojmë se ndihma dhe përkrahja jonë për të gjithë veteranët, pasardhësit e tyre dhe familjet e dëshmorëve, nuk do të shuhet..

* Fjala në promovimin e librit "PO KTHEHEM NË HOTESH" TË AUTORIT SHKËNDER MURRJA

